



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 712 Akti

Nr. 761 Vendimi  
Tiranë, më 14.5.2024

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Olsi Komici</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Firdes Shuli</b>	<b>Relatore</b>
<b>Valbona Sanxhaktari</b>	<b>Anëtare</b>

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Jonida Vrana, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier de Mongeot, në datën 10.5.2024, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Petref Asllani**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Firdes Shuli, mori në shqyrtim çdo provë dhe dokument të vënë në dispozicion nga organet kompetente ligjore, shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Petref Asllani, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

**1.** Z. Petref Asllani është subjekt rivlerësimi sipas nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016), për shkak të funksionit të tij si prokuror pranë Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.

**2.** Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, është zhvilluar shorti në datën 15.12.2020, në përfundim të të cilit rezultoi që subjekti i rivlerësimit Petref Asllani do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Olsi Komici, Firdes Shuli dhe Valbona Sanxhaktari. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionerja Firdes Shuli. Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016.

**3.** Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga: (i) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31-33 të ligjit nr. 84/2016; (ii) Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (në vijim AKSIK), sipas neneve 34 - 39, të ligjit nr. 84/2016; (iii) Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP), sipas neneve 40 - 44 të ligjit nr. 84/2016.

**4.** Me vendimin nr. 1, datë 15.1.2021, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Petref Asllani, si dhe të caktojë kryesues të trupit gjykues komisionerin Olsi Komici. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit. Subjekti deklaroi në rrugë elektronike se nuk ka konflikt interesi me anëtarët e trupit gjykues.

**5.** Me vendimin nr. 2, datë 15.4.2024, trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh prej relatores së çështjes me rezultatet e hetimit dhe me provat e grumbulluara për të tria kriteret, vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret e vlerësimit për subjektin e rivlerësimit Petref Asllani; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t’u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

**6.** Në datën 15.4.2024, përmes postës elektronike trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit administrativ për të tria kriteret; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të dhënë sqarime mbi konstatimet e Komisionit jo më vonë se data 30.4.2024; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative.

**7.** Në datën 17.4.2024, subjekti i rivlerësimit ka marrë kopje të akteve të dosjes. Në datën 29.4.2024, përmes postes elektronike subjekti i rivlerësimit kërkoi shtyrjen e afatit për paraqitjen e prapësimeve dhe provave. Me vendimin nr. 3, datë 30.4.2024, trupi gjykues vendosi shtyrjen e afatit për paraqitjen e parashtrimeve dhe provave deri në datën 7.5.2024.

**8.** Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, me vendimin nr. 4, datë 7.5.2024, trupi gjykues vendosi kalimin në seancë dëgjimore.

9. Në datën 10.5.2024 u zhvillua seanca dëgjimore, në të cilën subjekti i rivlerësimit dhe përfaqësuesi i tij me deklarin në seancë, av. F. L., ishin të pranishëm, dhe në përfundim kërkoi konfirmimin në detyrë.

## **II. PARIME TË PËRGJITHSHME TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT**

10. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

11. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera, që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

12. Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, AKSIK-ja (ish-DSIK-ja) është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin në lidhje me kontrollin e figurës. Sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

13. Referuar vendimit nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, Komisioni në kryerjen e funksionit të tij kushtetues ka realizuar një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse, bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, duke marrë në analizë: (i) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja dhe dokumentet shkresore të vëna në dispozicion nga ky institucion vlerësimi; (ii) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar nga AKSIK-ja dhe dokumentet shkresore të vëna në dispozicion nga ky institucion vlerësimi; (iii) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLP-ja dhe dokumentet shkresore të paraqitura prej tyre; (iv) provat shkresore/dokumentet e vëna në dispozicion nga institucionet apo subjektet publike a private; (v) denoncimet e publikut sipas nenit 53 të ligjit dhe çdo informacion të marrë në rrugë ligjore; (vi) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të rivlerësimit; (vii) sugjerime/opinione të vëzhguesit të ONM-së sipas nenit 49, pikat 10-12 të ligjit.

## **III. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI**

### **Vlerësimi i pasurisë**

14. Në zbatim të nenit 31/1 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Petref Asllani ka dorëzuar në ILDKPKI deklaratën e pasurisë në datën 28.1.2017, pra, në periudhën kur ligji ka qenë në fuqi dhe brenda afatit 30-ditor nga hyrja e tij në fuqi. Gjithashtu, në referencë të nenit 32/2 të ligjit nr. 84/2016 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, si dhe ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, z. Petref Asllani është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2003, kur ka dorëzuar deklaratën përpara fillimit të detyrës (në vijim DPF) me nr. indeksi \*\*\* dhe në vijim ka dorëzuar rregullisht deklaratat periodike vjetore (në vijim DPV).

15. ILDKPKI-ja ka dërguar aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera për subjektin Petref Asllani, ka konstatuar se: (a)

deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin; (b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; (c) ka kryer fshehje të pasurisë; (ç) ka kryer deklaram të rremë; (d) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

**16.** Në përmbushje të funksioneve të tij kushtetuese, sipas dispozitave ligjore të kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka kryer një proces të plotë hetimi administrativ për pasurinë e subjektit të rivlerësimit Petref Asllani, si dhe të personave të lidhur me të.

**17.** Hetimi administrativ në lidhje me rivlerësimin e pasurisë konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarameve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur në deklaramat periodike vjetore (në vijim DPV) dhe në deklaramen *Vetting*; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive; (iv) evidentimin e deklarameve të rreme; (v) nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, me qëllim vërtetimin ose jo të deklarameve të pamjaftueshme në lidhje me kriterin pasuror, sipas parashikimit të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

**18.** *Apartament banimi, sip. 77.8 m<sup>2</sup>, lagjja “\*\*\*\*”, rruga “\*\*\*\*”, pallati \*\*\*, shk. \*\*\*, kati \*\*\*, ap. \*\*\*, Elbasan. Blerë në datën 25.9.2012. Vlera: 3.821.536 lekë. Zotëron: 50 %. Burimi i krijimit: (i) 3.345.117 lekë, nga shitja e apartamentit me nr. pasurie \*\*\*, z. k. \*\*\*, lagjja “\*\*\*\*”, Elbasan, pall. \*\*\*, shk. \*\*\*, kati \*\*\*, ap. \*\*\*, sipas kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*/\*\*\*, datë 30.7.2010; deklaramë noteriale e shtetasit B. R. nr. \*\*\*/\*\*\*, datë 10.12.2014. Shihni relacionin shpjegues bashkëlidhur deklaramës; (ii) 476.719 lekë të ardhura nga paga.*

**19.** ILDKPKI-ja në lidhje me këtë pasuri ka konstatuar: *“Deklarim i rremë lidhur me apartamentin e banimit me sip. 68.29 m<sup>2</sup> në lagjen “\*\*\*\*”, Elbasan, sa i përket shitjes, marrjes së të ardhurave dhe banimit, pasi kontratat përkatëse të shitblerjes rezultojnë fiktive, krahasuar me shpjegimet e deklaramave noteriale të subjektit Petref Asllani dhe shtetasit B. R. Kontrata fiktive të subjektit, në bashkëpunim me shtetasin/subjektin Q. H., lidhur me shitblerjen e apartamentit me sip. 68.29 m<sup>2</sup>, në lagjen “\*\*\*\*”, Elbasan, me qëllim përfitim kredie nga Enti Kombëtar i banesave nga shtetasi Q. H. (kjo pasi i është akorduar kredi nga EKB-ja shtetasit Q. H. si i pastrehë, për strehimin e tij në apartamentin e shtetasit Petref Asllani, i cili de jure ia shiti EKB-së, por de facto ka vazhduar të jetojë aty). Deklarim i rremë i gjendjes cash në shumën 3.000.000 lekë, deklaruar në vitin 2012, me likuidimin nga blerësi B. R., shitësit Q. H.”*

## **20. Gjatë hetimit administrativ në lidhje nga dokumentacioni i administruar<sup>1</sup>, rezultoi se:**

- Me kontratë shitblerjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 25.9.2012, subjekti Petref Asllani ka blerë nga shtetasi E. K. apartament me sipërfaqe 77.8 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, Elbasan, në vlerën 3.821.526 lekë, vlerë e likuiduar jashtë zyrës noteriale përpara hartimit të kontratës.

- Pasuria është regjistruar në bashkëpronësi të shtetasve Petref D. Asllani dhe N. C. A., konfirmuar nga ZVRPP-ja<sup>2</sup> Elbasan. Edhe nga verifikimi në sistemin *online* të ASHK-së rezultoi se pasuria e llojit apartament me nr. \*\*\*, z. k. \*\*\*, me sip. 77.8 m<sup>2</sup>, me adresë rruga “\*\*\*\*”, ndërtesa nr. \*\*\*, shk. \*\*\*, ap. \*\*\*, Elbasan, është e regjistruar në bashkëpronësi të shtetasve Petref Asllani dhe N. A.

<sup>1</sup> Shihni aktet në aneksin \*\*\* dhe \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>2</sup> Shihni aneksin nr. \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së dhe printim karteles nga sistemi në dosjen e Komisionit.

- FSHU-ja<sup>3</sup> konfirmon kontratë furnizimi me energji elektrike në instancën Elbasan, në emër të subjektit Petref D. Asllani, në rrugën “\*\*\*\*”, me datë hapjeje 4.10.2004, me ndryshim emri datë 12.7.2016. Sipas të dhënave të FSHU-së, vërehet se që nga janari 2007 ka konsum normal të energjisë, pra që tregon përdorim të tij.

- UK Elbasan<sup>4</sup> konfirmon kontratë në emër të z. Petref D. Asllani kontratën me vendndodhje në lagjen “\*\*\*\*”.

## **21. Në lidhje me deklaratimet dhe përdorimin e këtij apartamenti rezultoi se:**

- Në DPV-të e viteve 2010 dhe 2011 subjekti ka deklaruar si adresë të gjendjes civile lagjen “\*\*\*\*”, Elbasan (adresa e pasurisë së shitur, trajtuar në vijim), dhe si adresë vendqëndrimi tjetër, adresën lagjja “\*\*\*\*”, pall. \*\*\*\* (adresa e pasurisë objekt vlerësimi). Në deklaratën *Vetting* ka deklaruar si adresë në gjendjen civile lagjen “\*\*\*\*”, bashkia Elbasan, ndërsa si vendqëndrim tjetër ka deklaruar lagjen “\*\*\*\*”, rr. “\*\*\*\*”, p. \*\*\*\* sh.\*\*\*\*, k. \*\*\*\*, ap. \*\*\*\*. Në pyetësonin nr. 1 ka deklaruar se nga shtatori 2012 e në vazhdim se ka banuar në lagjen “\*\*\*\*”, pall. \*\*\*\*, k. \*\*\*\*, ap. \*\*\*\*.

- Duke qenë se pasuria apartament nr. \*\*\*\* në lagjen “\*\*\*\*” ishte blerë me kontratë shitblerjeje në vitin 2012, gjatë procesit iu kërkuan sqarime subjektit në lidhje me deklaratimin e këtij apartamenti si adresë vendqëndrimi tjetër në DPV-të 2010/2011 dhe me ç’tagra është përdorur kjo pasuri prej tij përpara vitit 2012. Në përgjigje të pyetësonit nr. 2, subjekti deklaroi se në këtë apartament ka filluar të banojë në fundin e shtatorit 2012, pra pas blerjes së tij, dhe sqaroi se deklarimi i adresës së pasurisë si adresë vendqëndrimi tjetër në DPV 2010 dhe 2011 ka ndodhur për shkak se me administratorin e shoqërisë ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k., P. K. ( babai i E. K. shitësi i pasurisë), kishte negociuar që në muajin janar të vitit 2010 për të blerë apartamentin nr. \*\*\*\*, lagjja “\*\*\*\*”. Në këtë vit, këtij shtetasi i ka dhënë shumën 2.500 euro si garanci për blerjen e këtij apartamenti dhe ka qenë kjo arsyeja e deklaratimit të pasurisë si adresë vendqëndrimi tjetër në DPV-të e viteve 2010 dhe 2011. Ky fakt është i pavërtetuar me ndonjë provë shkresore dhe nuk justifikon deklaratimin e adresës së pasurisë si adresë vendqëndrimi tjetër.

- Me qëllim heqjen e dyshimeve që subjekti mund ta ketë blerë apartamentin që në vitin 2010 apo subjekti mund të ketë blerë një apartament tjetër banimi në të njëjtin pallat, Komisioni kërkoi informacion pranë FSHU-së nëse është lidhur një kontratë në emër të subjektit përpara vitit 2012 për apartamentin objekt vlerësimi dhe nëse ka pasur kontrata të tjera në emër të subjektit në të njëjtën godinë.

- Me shkresën kthim përgjigjeje nr. \*\*\*\* prot., datë 11.4.2024, FSHU-ja ka informuar se: (i) *me gjeneralitetet Petref D. Asllani me nr. ID \*\*\*\*, identifikohet një abonent me kontratë nr. \*\*\*\*, në instancën Elbasan dhe, referuar detajit të klientit, figuron adresa lagjja “\*\*\*\*”, \*\*\*\*. Pra, bëhet fjalë për apartamentin objekt vlerësimi të blerë në vitin 2012. Bashkëlidhur janë përcjellë disa dokumente, nga të cilat rezulton se sipas formularit me datë 9.7.2016 është paraqitur kërkesë për ndryshim emri nga P. K. në Petref Asllani, bashkëngjitur ndodhen edhe kontrata e shitblerjes nr. \*\*\*\* rep., nr. \*\*\*\* kol., datë 25.9.2012 dhe vërtetim hipotekor datë 22.11.2012, ku apartamenti nr. \*\*\*\* figuron në emër të subjektit dhe bashkëshortes së tij. Ndërsa sipas të dhënave të ardhura nga*

<sup>3</sup> Shihni shkresën kthim përgjigjeje të FSHU-së nr. \*\*\*\* prot, datë 2.2.2021 dhe nr. \*\*\*\* prot, datë 28.2.2022, në dosjen e Komisionit. Po nga informacioni i marrë nga FSHU-ja në emër të shtetasit Petref Asllani rezulton edhe kontrata me nr. \*\*\*\*. Subjekti informoi se ai ka vetëm një kontratë në emër të z. Petref D. Asllani me nr. \*\*\*\*, ndërsa kontrata me nr. \*\*\*\* i përket një personi tjetër me emrin P. Z. A., që s’ka asnjë lloj lidhjeje me të. Sipas tij, informacioni që gjeneron sistemi nuk është i plotë, për faktin se shtetasi Petref Z. Asllani nuk i ka të përditësuara të dhënat e tij në sistem. Subjekti paraqiti vërtetimin nr. \*\*\*\* prot., datë 25.2.2022, të FSHU-së, për të provuar këtë deklaram, po ashtu edhe nga verifikimi në sistemin e gjendjes civile figuron shtetasi me këto gjeneralitete.

<sup>4</sup> Shihni shkresën kthim përgjigjeje të UK Elbasan nr. \*\*\*\* prot., datë 21.2.2022, në dosjen e Komisionit.

departamenti i teknologjisë dhe informacionit bashkëlidhur shkresës, duket se në vitin 2004 kontrata është lidhur nga P. K. dhe veprime në emër të subjektit vërehen vetëm pas vitit 2012.

- Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.4.2024, FSHU-ja ka informuar se kontrata nr. \*\*\*, që i përket abonentit Petref D. Asllani, është hapur në datën 4.10.2004, duke bërë me dije se për sa i përket dosjes së plotë të dokumentacionit të lidhjes së kontratës nuk disponohen të dhëna.

- Siç vërehet, në informacionin e FSHU-së nuk ka të dhëna që tregojnë lidhjen e ndonjë kontrate në emër të subjektit para vitit 2012 apo të dhëna për pasuri të tjera të ndryshme nga ato të hetuara nga Komisioni. Megjithatë, në përfundim të hetimit mbetej ende e paqartë përse në deklaratimet e DPV-ve të viteve 2010 dhe 2011 apartamenti i blerë me kontratë të vitit 2012 në lagjen “\*\*\*\*” është deklaruar si adresë vendqëndrimi tjetër, ndërkohë që gjatë procesit të rivlerësimit subjekti ka deklaruar se në këtë apartament ka filluar të banojë pas muajit shtator 2012, kur është lidhur edhe kontrata e shitjes dhe se gjatë viteve 2010 dhe 2011 ka banuar në apartamentin në lagjen “\*\*\*\*”, shitur shtetasit Q. H. Me njoftimin e rezultateve të hetimit administrativ, subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me këtë konstatim.

Në parashtrimet e veta, ashtu si dhe gjatë hetimit administrativ, subjekti vijon të deklarojë se në apartamentin në lagjen “\*\*\*\*” ka filluar të banojë në vitin 2012, kur ka lidhur kontratën e shitjes. Si shkak të deklaratimit të adresës së kësaj pasurie si adresë vendqëndrimi tjetër në DPV-të e viteve 2010 dhe 2011, vite në të cilat ka banuar në apartamentin në lagjen “\*\*\*\*”, në pronësi të shtetasit Q. H., ka qenë se në muajin janar të vitit 2010, me qëllim që të merrte një apartament për të plotësuar më mirë nevojat e familjes, ka negociuar me administratorin e shoqërisë ndërtuese “\*\*\*\*” sh.p.k. me NUIS \*\*\*, shtetasin P. K., i cili i premtoi t’i shiste apartamentin nr. \*\*\*, lagjja “\*\*\*\*”, Elbasan. Me qëllim blerjen e këtij apartamenti subjekti deklaroi se ka ndërhyrë për shitjen e apartamentit në lagjen “\*\*\*\*” nga shtetasi Q. H. (i cili ka qenë në pronësi të subjektit, trajtuar ne vijim), duke negociuar me shtetasin B. R., i cili më 30.7.2010 bleu pasurinë me kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., në çmimin 3.345.117 lekë. Nga kjo shumë, sipas subjektit, në prani të B. iu dha P. K. shuma 2.500 euro, që shërbeu si parapagim për blerjen e apartamentit nr. \*\*\* të pallatit \*\*\*, lagjja “\*\*\*\*”, Elbasan. Sipas subjektit, pjesa tjetër e vlerës së apartamentit prej 3.000.000 lekësh iu dha (subjektit) nga B. në vitin 2012, shumë kjo që u përdor për blerjen e apartamentit nr. \*\*\* në lagjen “\*\*\*\*”. Subjekti i referohet deklaratës noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 10.12.2014, të shtetasit B. R. Sipas subjektit, kjo është arsyeja e deklaratimit në DPV-të e viteve 2010 dhe 2011 të kësaj adrese (në lagjen “\*\*\*\*”) si adresë të dytë.

**21.3** Në analizë të parashtrimeve, Komisioni vëren se të gjitha pohimet e subjektit janë në nivel deklarativ. Po kështu, në deklaratën e datës 10.12.2014, shtetasi B. R. nuk ka deklaruar në lidhje me dorëzimin e shumës 2.500 euro në vitin 2010 subjektit të rivlerësimit, sipas të cilit kjo shumë pastaj në të njëjtin moment dhe në prani të tij i është dhënë shtetasit P. K. Megjithatë, edhe nëse ky fakt do ishte i vërtetë, mbetet i pajustificuar deklarimi i adresës në lagjen “\*\*\*\*” si adresë vendqëndrimi tjetër, në kushtet kur vetë subjekti pohon se në vitin 2010 dhe 2011 nuk e ka përdorur si vendqëndrim këtë banesë. Në këto kushte, mbetet ende e paqartë deklarimi i subjektit në DPV-të e këtyre viteve, duke lënë dyshime për pagimin e çmimit të blerjes së pasurisë në lagjen “\*\*\*\*” që në vitin 2010, vit në të cilin subjekti nuk ka pasur mundësi financiare për blerjen e tij. Por, në vlerësimin përfundimtar të çështjes, nisur nga deklaratimet e paqarta e kontradiktore të subjektit të rivlerësimit, i cili jo në pak raste ka vështirësuar punën e Komisionit për të kryer procesin e rivlerësimit, trupi gjykues i është referuar kontratës së shitjes me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 25.9.2012, mbështetur në deklaratimet e subjektit si dhe deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 10.12.2014 të shtetasit B. R. (blerësit të apartamentit në lagjen “\*\*\*\*”, Elbasan), duke vlerësuar si vit të blerjes së pasurisë në lagjen “\*\*\*\*” vitin 2012.

## 22. Në lidhje me çmimin e blerjes së apartamentit dhe mënyrën e likuidimit të tij rezultoi se:

- Në kontratën e shitjes datë 25.9.2012 përcaktohet se çmimi prej 3.821.526 lekësh per blerjen e pasurisë në lagjen \*\*\* është likuiduar jashtë zyrës noteriale, përpara hartimit të kontratës.

- Në përgjigje të pyetësorit nr. 1, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 4.6.2012, të shtetasve E. K. (shitësi i pasurisë) dhe Petref Asllani, në të cilën subjekti ka deklaruar se në marrëveshje me z. E. K. ka rënë dakord t'i blejë atij pasurinë nr. \*\*\*, për të cilën i ka parapaguar shumën 30.000 euro, si dhe shumën 5.000 euro në datën e nënshkrimit të kësaj deklarate noteriale, ndërsa vlera e mbetur 15.000 euro do të likuidohet menjëherë me nënshkrimin e kontratës së shitblerjes përfundimtare, konfirmuar këto fakte edhe nga shtetasi E.K. . Në total, sipas kësaj deklarate, çmimi i blerjes së pasurisë është 50.000 euro.

-Në përgjigje të këtij pyetësori, subjekti ka dhënë disa sqarime në lidhje me likuidimin e çmimit të shitjes së pasurisë, duke përmendur dhe vëllain e tij, P. A. . Konkretisht, ka sqaruar se në vitin 2012 ka shpenzuar shumën 476.406 lekë (3.821.526-3.345,117) = 476.406 lekë. Pra, subjekti i referohet faktit që shumës së përfituar nga shitja e një apartamenti tjetër në Elbasan, në lagjen "\*\*\*\*", në vlerën 3.345,117 lekë, në vitin 2010, shtetasit B. R. (trajtuar më poshtë) i ka shtuar edhe vlerën 476.406 lekë. Në vijim, subjekti deklaroi se shuma 3.821.526 lekë i është dhënë shtetasit E. K. në këtë mënyrë: 15.000 euro i është dhënë në datën 27.6.2012 nëpërmjet transferimit, bashkë me vëllain P. A. , në nr. e llogarisë \*\*\* përfituesit \*\*\* (ku shitësi kishte lënë si garanci hipotekore apartamentin që bleu subjekti) dhe diferenca iu dha në lekë në momentin e kalimit të pronësisë, datë 25.9.2012. Më tej ka deklaruar se nga shuma 15.000 euro shtetasja E. K. (nëna e shitësit) i mori hua pa interes shumën prej 90.000 lekësh vëllait të subjektit P. A. , me afat shlyerjeje deri në datën 30.11.2012.

- Bashkëlidhur pyetësorit standard ka paraqitur aktet shkresore: (i) akt bankar i datës 27.6.2012 për depozitimin e shumës prej 15.000 euro në Raiffeisen Bank për përfituesin \*\*\*, me përshkrimin "Petref Asllani dhe P. A. derdh për llog. të dep. ligjor"; (ii) deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 22.9.2012, të shtetasve E. K. dhe Petref Asllani, në të cilën deklarohet njohja e detyrimit prej 15.000 euro e shtetasit Petref Asllani ndaj shtetasës E. K. , me qëllim realizimin përfundimtar të kontratës së shitjes së pasurisë apartament me sip. 77.8 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*; (iii) deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 19.11.2012, të shtetasve E. K. dhe P. A. (vëllai i subjektit) për njohje reciproke detyrimi të shtetasës E. K. ndaj shtetasit P. A. në shumën 90.000 lekë, të cilin duhet ta shlyejë brenda datës 30.11.2012.

- Duke qenë se deklaratimet e subjektit, ashtu sikurse dhe dokumentet e paraqitura në përgjigje të pyetësorit standard kanë qenë të paqarta dhe që vinin në kundërshtim me çmimin e blerjes së pasurisë sipas kontratës së blerjes me datë 25.9.2012, me pyetësorin nr. 2 iu kërkua subjektit të japë sqarime mbi çmimin e saktë të blerjes së këtij apartamenti, mënyrën e likuidimit të vlerës 50.000 euro sipas përmbajtjes së deklaratës datë 4.6.2012, përfituesin e shumës 15.000 euro, e cila ka kaluar në llogarinë bankare të *head office* nga Petref dhe P. A. , si dhe për huan e përmendur në deklaratimet e tij, në vlerën 90.000 lekë.

- Në përgjigje të këtij pyetësori, në mënyrë të përmbledhur subjekti deklaroi se çmimi i blerjes së apartamentit në lagjen "\*\*\*\*" është 3.821.526 lekë, sipas kontratës së blerjes me datë 25.9.2012, i likuiduar me para në dorë jashtë zyrës së noterisë. Në lidhje me vlerën 50.000 euro, e përmendur në deklaratën e datës 4.6.2012, ka sqaruar se kjo shumë nuk i përket vetëm blerjes së apartamentit të tij nr. \*\*\*, por edhe blerjes së një apartamenti \*\*\* nga vëllai i tij P. A. , duke lidhur pagesën e shumës 15.000 euro dhe huan 90.000 lekë pikërisht me një pasuri tjetër apartament nr. \*\*\* që vëllai do të blinte nga familja K., i cili së bashku me apartamentin nr. \*\*\* që ka blerë subjekti, sipas tij, kanë qenë nën sekuestro. Bashkëlidhur subjekti ka paraqitur disa dokumente shkresore.

**23.** Në analizë të të gjitha provave të administruara në raport me deklaratimet e subjektit, u konstatua se ka deklarime kontradiktore për çmimin e blerjes së pasurisë objekt vlerësimi dhe likuidimin e tij, pasi: (i) sipas deklaratës datë 4.6.2012 bashkëlidhur pyetësorit standard, çmimi i blerjes së apartamentit nr. 34 nga subjekti është 50.000 euro, duke u përcaktuar mënyra e likuidimit; (ii) sipas kontratës përfundimtare të shitjes me datë 25.9.2012, çmimi është 3.821.526 lekë dhe është likuiduar jashtë zyrës noteriale, përpara hartimit të kontratës (ky është çmimi referencë sipas EKB-së).

**24.** Në përfundim të hetimit administrativ, Komisioni çmoi të konsiderojë si çmim shitjeje të pasurisë vlerën 50.000 euro sipas deklaratës datë 4.6.2012 dhe jo çmimin e parashikuar në kontratën e shitjes 3.821.526 lekë, i cili duket të jetë një çmim fiktiv, për arsye se:

*Së pari*, pretendimet e subjektit që deklarata e datës 4.6.2012 nuk i përket çmimit të shitjes vetëm të apartamentit të tij nr. \*\*\*, por edhe një apartamenti me nr. \*\*\* që donte ta blinte vëllai i tij, P. A. , mbeten në nivel deklarativ, përderisa kjo deklarata është nënshkruar vetëm nga subjekti dhe shitësi i pasurisë P. K. (vëllai i subjektit nuk është deklarues), duke u specifikuar nr. \*\*\* i apartamentit të subjektit dhe në asnjë moment nuk është përfshirë emri i vëllait të subjektit P. A. dhe as apartamenti nr. \*\*\* i pretenduar se do të blihej prej tij.

*Së dyti*, me deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 22.9.2012, të shtetasve E. K. (nëna e shitësit) dhe Petref Asllani, deklarohet njohja e detyrimit prej 15.000 euro e shtetasit Petref Asllani, me qëllim realizimin përfundimtar të kontratës së shitjes së pasurisë apartament nr. \*\*\*, me sip. 77.8 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*. Tri ditë pas legalizimit të kësaj deklarate, në datën 25.9.2012 është lidhur dhe legalizuar me akt noterial kontrata përfundimtare e shitjes për këtë pasuri, ku çmimi i shitjes është vënë fiks sipas çmimit referencë të EKB-së, në vlerën 3.821.526 lekë. Siç vërehet, deklarata e datës 22.9.2012, në të cilën nuk përmendet në asnjë moment emri i vëllait të subjektit dhe as apartamenti nr.\*\*\* i pretenduar se do të blehej prej tij, por, përcaktohet shprehimisht nr. \*\*\* i apartamentit të subjektit, numri i pasurisë dhe sipërfaqja e apartamentit të blerë nga subjekti, është nënshkruar me qëllim që pala shitëse të sigurohej për pagimin e shumës 15.000 euro nga subjekti i rivlerësimit, për të plotësuar çmimin 50.000 euro të dakordësuar sipas deklaratës me datë 4.6.2012. Ndërsa çmimi prej 3.821.526 lekësh, sipas EKB-së, duket të jetë vënë minimalisht me qëllim evitimin e pagimit të tatimit mbi të ardhurën reale nga shitja. Nga ana tjetër, vënia e këtij çmimi do ta vinte subjektin në pozita më të favorshme për të justifikuar pagimin vetëm të vlerës 3.821.526 lekë (pasi, sikurse rezulton, subjekti nuk justifikon me të ardhura të ligjshme shumën 50.000 euro).

**24.1** Për këto arsye, në analizën financiare dërguar subjektit me rezultatet e hetimit administrativ si çmim i paguar për apartamentin në vitin 2012 është konsideruar vlera 50.000 euro. Shpenzimet e mobilimit janë konsideruar në vlerën 500.000 lekë, të kryera në vitin 2012 sipas vetëdeklarimit të subjektit në deklaratimet pranë ILDKPKI-së në vitin 2015.

### **Në lidhje me burimet e krijimit të pasurisë apartament**

**25.** Si burim për krijimin e të ardhurave për të blerë apartamentin me nr. pasurie \*\*\* në lagjen “\*\*\*\*”, në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar: (i) të ardhurat prej 3.345.117 lekësh nga shitja e apartamentit me nr. pasurie \*\*\*, lagjja “\*\*\*\*”, Elbasan, sipas kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*/\*\*\*, datë 30.7.2010; (ii) shumën 476.719 lekë me të ardhura nga paga, analizuar si vijoje.

**26.** Përpara se të verifikohet ligjshmëria e të ardhurave nga shitja e apartamentit me nr. pasurie \*\*\*, lagjja “\*\*\*\*”, Elbasan, sipas kontratës së shitblerjes nr. \*\*\*/\*\*\*, datë 30.7.2010, Komisioni ka administruar disa akte shpresore që kanë të bëjnë me një kallëzim penal në adresë të subjektit, i cili ka lidhje me këtë pasuri. Konkretisht, nga aktet shpresore rezultoi se:



- Në vitin 2014, ILDKPKI-ja ka paraqitur një kallëzim penal ndaj subjekteve Q. H. (gjqqtar) dhe Petref Asllani. Subjekti Petref Asllani është kallëzuar për: (i) deklaram të rremë në deklaratën para fillimit të detyrës dhe në deklaratat periodike vjetore për vitet 2004 – 2013, të likuiditetit në gjendjen *cash* në shumën 3.000.000 lekë, me burim krijimi nga shitja e apartamentit, kur *de facto* kjo shumë e përfituar nga “shitja” e apartamentit është disponuar nga z. H.; (ii) fshehje në deklaratën periodike vjetore 2010 të përfitimit të shumës prej 3.345.117 lekësh nga shitja reale e apartamentit në datën 30.7.2010; (iii) mashtrim në bashkëpunim me subjektin Q. H. .

- Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë ka regjistruar në ngarkim të të pandehurve Petref Asllani dhe Q. H. procedimin penal nr. \*\*\*, viti 2015, të akuzuar për kryerjen e veprës penale “Refuzimi për deklaram, mosdeklaram, fshehja ose deklarami i rremë i pasurisë, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose çdo personi tjetër që ka detyrimin për deklaram”, të parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal. Ndaj subjektit Petref Asllani Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë në datën 8.5.2015 ka dhënë masën e sigurimit të pezullimit nga detyra përkohësisht, deri në përfundim të hetimit dhe gjykimit të çështjes penale.

- Në përfundim të gjykimit të çështjes, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 23.5.2016, ka vendosur deklaramin e pafajshëm të të pandehurit Petref Asllani për veprën penale (si më sipër) të parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal, pasi fakti nuk përbën veprën penale. Ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. \*\*\*, datë 13.7.2017. Subjekti ka paraqitur vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë nr. \*\*\*, datë 23.5.2016, në përgjigje të pyetësorit nr. 2.

**27.** Nga shqyrtimi i akteve në dosjen e ILDKPKI-së u verifikuan në rend kronologjik veprimet juridike që kanë pasur për objekt apartamentin në lagjen “\*\*\*\*”, Elbasan, me nr. pasurie \*\*\*, si vijon:

- Me kontratën e shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 4.8.2000, subjekti Petref Asllani ka blerë nga shtetasi A. K. banesë 2+1 në pallatin \*\*\*, ap. \*\*\* lagjja “\*\*\*\*”, Elbasan, kundrejt çmimit 300.000 lekë, paguar në dorë jashtë zyrës noteriale. Sipas vërtetimit nga dokumenti hipotekor i datës 11.9.2000, kjo pasuri rezulton e regjistruar në pronësi të subjektit Petref Asllani (analiza në lidhje me çmimin e blerjes së pasurisë është kryer në paragrafin 31).

- Me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*/\*\*\*, datë 27.1.2001, apartamentin e mësipërm subjekti ia ka shitur EKB-së Elbasan në çmimin 2.258.000 lekë (pra, disa herë më shtrenjtë) dhe, sipas vërtetimit nga dokumentet hipotekore të datës 27.7.2001, pasuria u regjistrua në pronësi të EKB-së. Nuk rezulton të jetë vendosur barrë mbi pasurinë. Sa i takon mënyrës si është likuiduar çmimi i shitjes, me mandatpagesën e datës 2.8.2001 të Bankës së Kursimeve, EKB Elbasan ka paguar në favor të subjektit shumën 2.258.000 lekë, me përshkrimin “Blerje në tregun e lirë”. Kjo pasuri nuk është deklaram nga subjekti në DPFD-në për vitin 2003 pasi është shitur në vitin 2001, por është deklaram si adresë banimi në DPV që prej vitit 2003 – 2010 dhe si adresë e gjendjes civile deri në deklaramin *Vetting* dhe DPV-në e vitit 2016. Ndërsa në përgjigjet e pyetësorit nr. 1 subjekti ka deklaram se ka banuar në këtë apartament nga muaji gusht 2000 deri në muajin shtator 2012, kur ka blerë apartamentin në lagjen “\*\*\*\*” .

- Pasi është lidhur një kontratë shitjeje me këste/kusht, nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 27.9.2001, midis EKB-së dhe shtetasit Q. H. , me kontratë shitjeje me pagesë të menjëhershme të datës 27.7.2010, EKB-ja i ka shitur shtetasit Q. H. pasurinë me nr. \*\*\*, ap. \*\*\*, pall. \*\*\*, lagjja “\*\*\*\*”, Elbasan, me sip. 68.29 m<sup>2</sup>, në vlerën 2.258.000 lekë. Nga dokumentet që subjekti ka paraqitur, vërtetohet se shtetasi Q. H. e ka përfituar apartamentin si i pastrehë, fakt që konfirmohet edhe me të dhënat e kontratës përfundimtare të shitblerjes së pasurisë së paluajtshme nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\*

kol., datë 28.7.2010, sipas së cilës vlera e apartamentit të ndërtuar/blerë me fonde shtetërore është 2.348.320 lekë.

- Sipas vërtetimit nga dokumenti hipotekor datë 30.7.2010, pasuria apartament në pallatin nr. \*\*\*, lagjja \*\*\*\*\*, me nr. pasurie \*\*\*, me sip. 68.29 m<sup>2</sup>, figuron në pronësi të shtetasit Q. H. dhe familjarëve të tij.

- Me kontratë shitblerjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 30.7.2010, shtetasi Q. H. dhe familjarët e tij i kanë shitur shtetasit B. R. apartamentin me nr. pasurie \*\*\*, me sip. 68.29 m<sup>2</sup>, kundrejt çmimit 3.345.117 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale.

- Sipas vërtetimit nga dokumenti hipotekor i datës 12.8.2010, apartamenti nr. \*\*\*, me sip. 68.29 m<sup>2</sup>, figuron në pronësi të shtetasit B. R. .

**28.** Siç vërehet, të ardhurat nga kontrata e shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 30.7.2010, të pasurisë në lagjen \*\*\*\*\*, deklaruar nga subjekti në deklaratën *Vetting* si burim krijimi i pasurisë në lagjen \*\*\*\*\*, blerë me kontratë shitjeje të vitit 2012, nuk është lidhur nga subjekti dhe/ose bashkëshortja e tij në cilësinë e palës shitëse, por është lidhur mes shtetasve Q. H. , shitës, dhe B. R. , blerës. Lidhur me këtë fakt subjekti ka dhënë deklaratime në relacionin e paraqitur bashkëngjitur deklaratës *Vetting*, ku në mënyrë të përmbledhur ka sqaruar se:

- Ky apartament është blerë prej tij me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 4.8.2000, në shumën 300.000 lekë.

- Ky apartament nga viti 2001 deri në vitin 2010 ka shërbyer si garanci pasurore për marrjen e një kredie, dhënë nga EKB Elbasan nominalisht familjes H., të cilët kishin përfituar statusin e të pastrehut.

- Në vitin 2010, familja H. këtë apartament ia ka shitur në shumën 3.345.117 lekë drejtpërdrejt shtetasit B. R. . Ky veprim juridik është kryer për të mos lidhur dy kontrata shitblerjeje nga familja H. tek subjekti dhe nga subjekti tek B. R. . Shumën prej 3.345.117 lekësh shtetasi B. R. e ka likuiduar faktikisht në vitin 2012, por në këtë vit nuk është përpiluar dokument ligjor dhe kjo vërtetohet sipas tij me deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 10.12.2014, të shtetasit B. R. .

- Subjekti e ka paraqitur këtë deklaratë, ku shtetasi B. R. ka deklaruar se në vitin 2010 ka blerë nga shtetasi Q. H. apartamentin 2+1, me sip. 68.29 m<sup>2</sup>, në lagjen \*\*\*\*\*, Elbasan, apartament në të cilin faktikisht jetonte shtetasi Petref Asllani, i cili banoi në këtë apartament derisa u sistemua në apartamentin e ri (është fjala për apartamentin e deklaruar në deklaratën *Vetting*, lagjja \*\*\*\*\*, blerë në vitin 2012). Më tej, deklaruesi B. R. ka deklaruar se ka hyrë për të banuar në këtë apartament në vitin 2012, kohë kur ka bërë edhe likuidimin e çmimit për blerjen e tij. Siç vërehet, shtetasi B. R. nuk pohon faktin që shumën e paguar për blerjen e këtij apartamenti ia ka dhënë subjektit të rivlëresimit.

- Në vijim, subjekti ka deklaruar se në lidhje me këto fakte ka dhënë shpjegime edhe përpara inspektorit të ILDKPKI-së, në shkurt 2015. Nga verifikimet rezultoi se në këtë procesverbal subjekti ka deklaruar që shuma prej 3.345.117 lekësh është përfituar prej tij nga shitja e pasurisë në lagjen \*\*\*\*\*, Elbasan, në vitin 2012 dhe është përdorur si burim krijimi për blerjen e apartamentit me nr. pasurie \*\*\* (në lagjen \*\*\*\*\*)).

Siç vërehet nga deklaratimet në relacion, subjekti lë të kuptohet se pavarësisht se apartamentin në lagjen \*\*\*\*\*, Elbasan ia ka shitur EKB-së, në vitin 2001, *de facto* nuk e ka humbur pronësinë mbi të, pasi ka vazhduar ta përdorë deri në vitin 2012 kur bleu apartamentin në lagjen \*\*\*\*\*, Elbasan, dhe se të ardhurat nga shitja e pasurisë nuk i ka përfituar shtetasi Q. H. , por subjekti i rivlëresimit.

**29.** Nga verifikimi i DPDFD-së 2003, subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në banesë në shumën 3 milionë lekë me burim nga shitja e apartamentit, por gjatë procesit deklaror se në këtë shumë përfshihen edhe kursimet e tij. Ndërsa referuar vendimit të gjykatës penale, nr. 1668, datë 23.5.2016, gjatë gjykimit është provuar se kjo shumë i është dhënë nga subjekti shtetasit Q. H. nisur nga marrëdhëniet shoqërore midis kolegësh që ata kishin, dhe është konsideruar nga gjykata si hua. Gjykata në arsyetim i referohet formularit të deklaratës përkatëse në rubrikën e likuiditeteve, me të cilat kuptohet gjendja *cash* në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie. Ky konstatim i gjykatës nuk është i bazuar, për shkak se në rubrikën “Likuiditete” të këtij formulari subjekti ka deklaruar vetëm një nga elementët e termit *likuiditete*, atë të gjendjes *cash*, duke deklaruar shprehimisht “*Gjendje cash, 3 milionë lekë, të ndodhura në banesë, me burim nga shitja e apartamentit*”, duke mos deklaruar asnjë huadhënie, apo personin të cilit i është dhënë kjo hua. Pra, referuar vetëdeklarimit të subjektit, shuma 2.258.000 lekë ka qenë gjendje *cash* në banesë (diferenca ka qenë nga kursimet po sipas deklarimeve të subjektit). Nga ana tjetër, nuk ka asnjë akt që të vërtetojë ndonjë marrëdhënie huaje të subjektit dhe shtetasit Q. H. .

**30.** Nga sa më sipër, në mënyrë të përmbledhur, në përfundim të hetimit administrativ, u konstatua se:

- Subjekti ka kryer deklaram të rremë në deklaratën *Vetting* në lidhje me burimin e të ardhurave nga shitja e pasurisë me nr. pasurie \*\*\*, në lagjen “\*\*\*\*”, Elbasan, me sip. 68.29 m<sup>2</sup>, me kontratën e datës 30.7.2010, në vlerën 3.345.117 lekë, pasi në këtë kontratë palë shitëse nuk ka qenë subjekti, por shtetasi Q. H. . Në mënyrë të paprovuar dhe jo të legjitimuar subjekti ka deklaruar që të ardhurat nga shitja e kësaj pasurie janë përfituar prej tij pas dy vitesh, në vitin 2012, pasi nuk ka asnjë provë që të vërtetojë të ardhura të përfituara prej subjektit nga shitja e kësaj pasurie si në vitin 2010, ashtu dhe në vitin 2012. Përkundrazi, u vërtetua që subjekti ia ka shitur EKB-së Elbasan apartamentin me nr. pasurie \*\*\*, në lagjen “\*\*\*\*” që në vitin 2001 me çmim 2.258.000 lekë, shumë e kaluar në rrugë bankare, apartament i cili u regjistrua në pronësi të EKB-së. Edhe në DPV-të e viteve 2010 dhe 2012 nuk rezulton të ketë deklaruar të ardhura nga shitja e kësaj pasurie, ndërkohë që këto të ardhura i ka deklaruar në DPDFD-në e vitit 2003.

- Subjekti ka kryer deklarime kontradiktore e të pabazuara në akte shkresore, pasi nga njëra anë në DPV-në e vitit 2003 ka deklaruar se likuiditeti *cash* në banesë është me burim nga shitja e pasurisë dhe, nga ana tjetër, në përgjigje të pyetësorit nr. 2. deklaror se shumë prej 2.258.000 lekësh ia dha Entit Kombëtar të Banesave si garanci për shlyerjen e kredisë nga familja ., i cili ka lidhur kontratën e parë me EKB-në në vitin 2001, pa e mbështetur këtë fakt me ndonjë akt shkresor. Po kështu, përkundër sa deklaror subjekti se shuma i është dhënë si garanci EKB-së, në vendimin e gjykatës pasqyrohet që subjekti i ka dhënë një hua shtetasit Q. H. , ndërkohë që gjatë procesit të rivlerësimit subjekti në asnjë moment nuk ka deklaruar shprehimisht se këtë shumë ia ka dhënë shtetasit Q. H. në formë huaje. Më tej, në deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 9.11.2011, subjekti ka deklaruar se: (i) pas kërkesës së paraqitur nga shtetasi Q. H. , kanë rënë dakord që apartamenti të shërbente si garanci për kredinë që ky ka marrë nga EKB-ja; (ii) shtetasi Q. H. ka garantuar subjektin që nuk do të kishte asnjë lloj shqetësimi dhe se do të vijonte të qëndronte në shtëpinë e tij pa asnjë shqetësim. Për këtë arsye, ia ka shitur formalisht shtëpinë EKB-së.

**30.1** Siç vërehet, referuar deklarimit të subjektit se apartamenti i është shitur formalisht EKB-së në vitin 2001, deklarimeve të paqarta e të dhënave kontradiktore (në një rast deklarohet se apartamenti është vënë si garanci për EKB-në, në një rast deklarohet se shuma e përfituar nga shitja e tij është vënë si garanci, ndërsa gjykata penale pranon se shuma e përfituar nga shitja e pasurisë i është dhënë si hua shtetasit Q. H. ), si dhe faktit që subjekti ka jetuar në apartament pa

ndërprerje pas shitjes tek EKB-ja në vitin 2001 deri në vitin 2012, duket se subjekti ka kryer veprime fiktive në lidhje me apartamentin nr. \*\*\*, në lagjen “\*\*\*\*”, Elbasan.

**30.2** Bazuar në të gjitha sa më sipër, në përfundim të hetimit administrativ, të ardhurat prej 3.345.117 lekësh, përfituar nga shitja e pasurisë në lagjen “\*\*\*\*”, Elbasan, sipas kontratës së shitjes me datë 30.7.2010, me palë shitëse Q. H. dhe palë blerëse B. R. , nuk mund të konsideroheshin si burim për blerjen e pasurisë objekt verifikimi apartament në lagjen “\*\*\*\*” nga subjekti me kontratë të datës 25.9.2012. Ndërkohë, është konsideruar si e ardhur shuma 2.258.000 lekë e përfituar nga shitja e këtij apartamenti EKB-së në vitin 2001, deklaruar si gjendje *cash* në DPDFD-në e vitit 2003.

**31.** Nga ana e Komisionit është verifikuar në vijim mënyra e blerjes së pasurisë me nr. \*\*\*, lagjja “\*\*\*\*”, Elbasan, me sip. 68.29 m<sup>2</sup>, me kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 4.8.2000, kundrejt çmimit 300.000 lekë (pasuri e shitur EKB-së në vitin 2001, në vlerën 2.258.000 lekë).

**31.1** Në lidhje me vlerën e kësaj pasurie dhe transaksionet e kryera me të deri në momentin e blerjes nga subjekti në çmimin 300.000 lekë, Komisioni ka administruar dokumentacionin e vënë në dispozicion prej tij në pyetësin nr. 2, nga ku rezultoi se në rend kronologjik janë kryer veprimet si vijojnë:

- Me kontratë shitjeje banese nr. \*\*\*/\*\*\*\*, datë 22.6.1993, Ndërmarrja Komunale Banesa i ka shitur shtetasit M. S. një banesë në lagjen “\*\*\*\*”, pallati nr. \*\*\*, ap. \*\*\*, kundrejt vlerës 9.660 lekë dhe 1.780 lekë truall;

- Me kontratë shitblerjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 4.2.1994, apartamenti në lagjen “\*\*\*\*”, pallati nr. \*\*\*, ap. \*\*\*, i shitet shtetasit G. Sh. me çmimin 10.300 USD nga bashkëpronarët M., V., M. dhe R. S.

- Në datën 1.8.2000, me kontratën e shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., ky apartament është blerë nga A. K. për çmimin 400.000 lekë, i cili pas tri ditëve, në datën 4.8.2000 ia ka shitur subjektit të rivlerësimit me çmimin 300.000 lekë, me kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 4.8.2000. Komisioni ka analizuar çmimin e blerjes së apartamentit me sip. 68.29 m<sup>2</sup>, duke e krahasuar me çmimin referues të EKB-së, të përcaktuar në vendimin e vitit 2000<sup>5</sup>, i cili referon se nga të dhënat e tregut të lirë të apartamenteve për vitin 2000 për qytetin e Elbasanit përcaktohet çmimi 79.615 lek/m<sup>2</sup>. Duke llogaritur sipërfaqen 68.29 m<sup>2</sup> x 44.790 lekë/m<sup>2</sup>, vlera sipas EKB-së është 3.058.709 lekë, ndërsa vlera e kontratës së blerjes nga subjekti është 300.000 lekë.

- Me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\*/\*\*\*\*, datë 27.1.2001, apartamentin e mësipërm subjekti ia ka shitur EKB-së Elbasan në çmimin 2.258.000 lekë.

**31.2.** Pra, në mënyrë të përmbledhur konstatohet se:

- Shitësi A. K. ia ka shitur subjektit të rivlerësimit apartamentin me çmimin 300,000 lekë vetëm 3 ditë pasi ai vetë e kishte blerë atë për 400,000 lekë, ku dhe vetë shtetasi A. K. e kishte blerë rreth 2.5 herë më lirë se blerësi i mëparshëm në vitin 1994 për 10.300 dollarë<sup>6</sup> ose 1.028.867 lekë.

- Çmimi i shitjes së këtij apartamenti në tregun e lirë në momentin e blerjes nga subjekti i rivlerësimit rezulton të jetë 3.058.709 lekë ose rreth 10 herë më i lartë se çmimi që subjekti e ka blerë sipas kontratës së shitjes në datën 4.8.2000, në çmimin 300.000 lekë.

- Subjekti e ka shitur pasurinë rreth pesë muaj më vonë, në datën 27.1.2001, në çmimin 2.258.000 lekë. Në deklaratën para fillimit të detyrës, viti 2003, subjekti ka deklaruar: “*Gjendje cash, 3*

<sup>5</sup> Vendim nr. 362, datë 14.7.2000 “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banësive dhe të koeficientit “k” për vitin 2000”.

<sup>6</sup> 10.300 dollarë x 99.8 = 1.028.867 lekë.

*milionë lekë, të ndodhura në banesë, me burim nga shitja e apartamentit” (gjatë procesit subjekti ka deklaruar se pjesa tjetër është me kursime familjare).*

Bazuar në sa më sipër, duket se çmimi i shënuar në kontratën e shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 4.8.2000, prej 300.000 lekësh, nuk është çmimi real i paguar nga subjekti i rivlerësimit. Për këto arsye, në analizën financiare, deri në përfundim të hetimit administrativ, si çmim i paguar nga subjekti për apartamentin në vitin 2000 është konsideruar 2.258.000 lekë, sa ishte çmimi që ka paguar EKB-ja Elbasan për blerjen e pasurisë nga subjekti në datën 27.1.2001.

**31.3.** Në lidhje me burimin e të ardhurave për blerjen e apartamentit në lagjen “\*\*\*\*”, në relacionin e dorëzuar bashkë me deklaratën *Vetting*, subjekti deklaroi si burim krijimi të shumës prej 300.000 lekësh të ardhurat nga paga e tij dhe e bashkëshortes. Në pyetësin nr. 2, subjekti ka ndryshuar burimin duke deklaruar se: “...Burimi i krijimit të vlerës 300.000 me të cilën është blerë apartamenti, është nga shitja e apartamentit të ndodhur në pallatin \*\*\*, lagjja “\*\*\*\*”, Elbasan, nga vëllai Q. A., me të cilin ishim në një familje të pandarë ekonomikisht”. Subjekti ka depozituar edhe një deklaratë noteriale<sup>7</sup> të shtetasit Q. A. (vëllai i subjektit), i cili deklaroi se: “Deri në vitin 2000 ai me vëllain ka jetuar si një familje e vetme në një ekonomi të përbashkët me prindërit. Në vitin 1996 me kontributin e përbashkët të familjes kanë blerë në qytetin e Elbasanit, në lagjen “\*\*\*\*”, në pallatin \*\*\*, një apartament banimi, i cili u regjistrua në emrin e tij (Q. A.), por në të banoi familja e Petref Asllanit deri në vitin 2000, kur kjo hyrje u shit në shumën 400.000 lekë, shumë të cilën ne si familje ia dhamë subjektit për të blerë një apartament në lagjen “\*\*\*\*”, pallatin \*\*\*, Elbasan. Gjithashtu, me shkëputjen nga trangu, nga kontributi në vite i dhanë edhe një shumë të hollash prej 300.000 lekësh”.

Siç vërehet, ka deklarime kontradiktore në deklarimin e burimit të kësaj pasurie. Sa i takon deklaratimeve në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ato janë në nivel deklarativ dhe të pambështetura në asnjë provë që të vërtetojë se subjekti ka përfutur të ardhura nga shitja e apartamentit të ndodhur në pallatin \*\*\*, lagjja “\*\*\*\*”, Elbasan, nga vëllai Q. A.

**31.4.** Në tabelën më poshtë paraqitet në mënyrë të përmbledhur analiza financiare për të verifikuar mundësinë financiare të subjektit dhe bashkëshortes së tij për të investuar në blerjen e apartamentit të banimit në lagjen “\*\*\*\*” në shumën 2.258.000 lekë, në datën 4.8.2000 (kur subjekti ka qenë në detyrë), bazuar në të ardhurat e dokumentuara gjatë kësaj periudhe të subjektit dhe bashkëshortes së tij, si dhe shpenzimet jetike sipas standardit të ILDKPKI-së.

Përshkrimi	1.7.1995 – 4.8.2000
<b>Pasuritë</b>	<b>2,258,000</b>
Apartament me sip. 68.29 m <sup>2</sup> , lagjja “****”	2,258,000
<b>Të ardhurat</b>	<b>1,314,941</b>
Të ardhurat nga paga subjekti	1,314,941
Të ardhurat nga paga bashkëshortja e subjektit	0
<b>Shpenzimet</b>	<b>979,379</b>
Shpenzime jetike	979,379
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>-1,922,439</b>

**31.5.** Në përfundim të hetimit administrativ në lidhje me apartamentin e banimit në lagjen “\*\*\*\*”, Elbasan, duket se: (i) çmimi i shënuar në kontratën e shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 4.8.2000, prej 300.000 lekësh është fiktiv; (ii) subjekti nuk ka justifikuar me të ardhura të ligjshme blerjen e apartamentit më 4.8.2000 në vlerën prej 2.258.000 lekësh për shkak të balancës negative 1.922.439

<sup>7</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 8.3.2022.

lekë; (iii) ka mospërputhje në deklaratimet e burimit të kësaj pasurie. Sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e këtyre konstatimeve.

**32.** Në parashtrimet e veta, subjekti deklaroi se çmimi prej 300.000 lekësh i shënuar në kontratën e shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 4.8.2000, është çmimi real i blerjes, duke iu referuar faktit se kontrata është një veprim juridik i dyanshëm, i lidhur me vullnetin e palëve sipas dispozitave të Kodit Civil dhe ka fuqinë e ligjit. Sa i takon blerjes së pasurisë nga shitësi A. K., me të cilin nuk ka asnjë lloj lidhjeje, me një çmim të përafërt prej 400.000 lekësh, pretendon se do të ishte joproportionale që t'i kërkohej atij arsye pse ka ndodhur kjo.

**32.1** Subjekti i referohet faktit se çmimi i shitjes prej 2,258,000 lekësh ka qenë për shkak të vlerësimit nga Enti Kombëtar i Banesave dhe i përdorjes së kësaj prone si garanci për shlyerjen e shumës së lekëve, që i është dhënë për blerje apartamenti një familjeje të pastrehë.

**32.2** Sipas subjektit, çmimi i blerjes 300.000 lekë është real dhe jofiktiv dhe se në një procedurë administrative hamendësimet nuk mund të ngarkojnë atë me barrë prove apo përgjegjësi disiplinore, pasi një qëndrim i tillë vjen në kundërshtim me kërkesat ligjore të parashikuara në Aneksin e Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016, që shërbejnë si bazë për këtë proces. Duke pretenduar se konsiderimi nga Komisioni i çmimit të blerjes sipas referimit tek të dhënat e EKBN-së është në kundërshtim me ligjin, pasi Kushtetuta dhe ligji parashikojnë kalimin e pronësisë nëpërmjet kontratës dhe regjistrimit të saj, subjekti pretendon se Komisioni ka bërë interpretim të gabuar të çmuarjes së provave, duke injoruar të gjitha shpjegimet dhe provat e tij si subjekt i rivlerësimit.

**32.3** Sa i takon burimit të të ardhurave për blerjen e pasurisë dhe mospërputhjeve në deklaratime, subjekti në mënyrë të përgjithshme parashtron se burimet e pasurisë të deklaruara në deklaratën *Vetting* derivojnë dhe ndërthuren me vite të mëparshme kalendarike, duke nisur nga viti 2003 e në vijim, dhe se nuk ka mospërputhje. Sipas subjektit, në varësi të pyetjeve të parashtruara në pyetësorë mund të ketë dhënë shpjegime më të detajuara mbi mënyrën e krijimit të burimit të të ardhurave, por nuk ka deklaruar burime të ndryshme për krijimin e pasurisë. Më tej, subjekti deklaroi se të gjitha konstatimet e Komisionit dhe barra e provës e ngarkuar për këtë pasuri ka qenë e shpjeguar detajisht dhe me relacionin bashkëlidhur deklaratës *Vetting*.

Subjekti bashkëlidhur parashtrimeve ka depozituar përgjigjen e ASHK-së<sup>8</sup> në lidhje me dosjen e kësaj pasurie.

**32.4** Në analizë të parashtrimeve, në përfundim të procesit Komisioni vlerësoi se subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës në lidhje me konstatimin se çmimi i blerjes së pasurisë prej 300.000 lekësh në datën 4.8.2000 është një çmim fiktiv. Përveç argumentave se kontrata e shitblerjes përbën provë të pakundërshtueshme, subjekti nuk ka dhënë shpjegime bindëse në lidhje me luhatjet e çmimeve të shitblerjeve të pasurisë ndër vite, dhe veprimet e shitblerjes së kësaj pasurie ku palë është subjekti bien dukshëm në kundërshtim me logjikën ekonomike në tregun e pasurive të paluajtshme. Për Komisionin mbetet e pajustificuar financiarisht blerja nga subjekti e apartamentit 25% më lirë vetëm 3 ditë pasi shitësi e kishte blerë atë si dhe, shitja pas 5 muajsh me çmimin 2.258.000 lekë ose 7.5 herë më shumë se çmimi i blerjes (rreth 750 % e çmimit të blerjes). Përtej këtyre fakteve, në vlerësimin përfundimtar Komisioni mban në konsideratë edhe sjelljen, veprimet dhe deklaratimet e subjektit në lidhje me këtë apartament i cili edhe pas shitjes në vitin 2001 ka mbetur në posedim të tij deri në vitin 2012, dhe një vlerësim tërësor i të gjitha fakteve dhe provave të administruara i bën të pabesueshme shpjegimet mbi çmimin blerjes së këtij apartamenti në vlerën prej 300.000 lekësh. Por Komisioni, në përfundim të procesit ashtu si dhe në përfundim të hetimit administrativ, nuk i është referuar

<sup>8</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 3.5.2024, të ASHK-së Elbasan dhe dokumentacionin bashkëlidhur.

vlerës së tregut sipas EKB-së prej 3.058.709 lekë (subjekti pa te drejtë ka parashtruar se në mënyrë të gabuar Komisioni i është referuar kësaj vlere), por çmoi të konsiderojë minimalisht si vlerë të blerjes së pasurisë pikërisht shumë 2.258.000 lekë që subjekti përfitoi nga shitja e pasurisë në datën 27.1.2001, duke vlerësuar çmimin 300.000 lekë të blerjes përpara pesë muajve, me kontratë të datës 4.8.2000, si çmim fiktiv.

**32.5** Sa i takon mospërputhjes në deklaratime për burimin e pasurisë, Komisioni çmon se në mënyrë të paqartë subjekti u referohet deklaratimeve ndër vite të burimit të pasurisë, për sa kohë kjo pasuri është blerë në vitin 2000, kur subjekti nuk ka qenë subjekt deklarues. Për herë të parë krijimin e kësaj pasurie me të ardhura nga pagat e tij dhe bashkëshortes subjekti i ka deklaruar në deklaratën *Vetting*. Ndërsa gjatë procesit ka deklaruar një burim tjetër, atë nga shitja e apartamentit të ndodhur në pallatin \*\*\*, lagjja “\*\*\*”, Elbasan, nga vëllai Q. A., me të cilin pretendon se ishte në një familje të pandarë ekonomikisht. Në këto kushte dhe për sa kohë nuk u vërtetua që subjekti ka përfituar të ardhura nga shitja e këtij apartamenti nga vëllai i tij i cili sipas dokumentacionit rezultoi pronar dhe shitës i pasurisë si dhe në kushtet kur nuk u paraqit ndonjë provë që të ardhurat nga shitja e apartamentit i janë dhuruar subjektit nga vëllai, edhe në përfundim të procesit nuk ka ndryshime në analizën financiare të kryer për këtë pasuri në rubrikën e të ardhurave. Për rrjedhojë, balanca negative për krijimin e kësaj pasurie prej 1.922.439 lekësh mbetet e pandryshueshme.

**33.** Me qëllim kryerjen e analizës financiare, për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi, apartament banimi në lagjen “\*\*\*”, Elbasan, në vitin 2012, në çmimin 50.000 euro, janë verifikuar deklaratimet e subjektit ndër vite, si vijojnë:

- Subjekti ka deklaruar në vitin 2003 gjendje *cash* në banesë 3.000.000 lekë me burim të ardhurat nga shitja e apartamentit.

- Në deklaratat periodike 2004 – 2009, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar shtesa/pakësime të gjendjes *cash*.

- Në deklaratën periodike të vitit 2010, subjekti deklaroi 250.000 lekë me burim “*Kursime nga paga si prokuror të mbajtura në shtëpi*”.

- Në vitin 2011, subjekti deklaroi përsëri 250.000 lekë me burim “*Kursime nga paga si prokuror të mbajtura në shtëpi*”.

- Në vitet 2012 dhe 2013, subjekti nuk deklaroi ndryshime të gjendjes *cash*.

- Në deklaratën e vitit 2014, subjekti deklaroi 700.000 lekë kursime nga të ardhurat e pagës neto si prokuror për vitin 2014.

- Edhe në vitin 2015 subjekti deklaroi kursime *cash* në vlerën 350.000 lekë me burim “*Kursime nga të ardhurat e pagës neto si prokuror për vitin 2014*”.

- Në deklaratën periodike të vitit 2016, subjekti nuk deklaroi ndryshime të gjendjes *cash*.

**33.1** Nga leximi i deklaratave periodike gjendja *cash* në datën 31.12.2016 është 4.550.000 lekë, pasqyruar në mënyrë të përmbledhur në tabelën me poshtë. Në deklaratën *Vetting*, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kursime *cash*.

Viti	2003	2004-2009	2010	2011	2012-2013	2014	2015	2016
Deklarim	<i>Gjendje në cash në banesë. Vlera 3,000,000 lekë. Burimi: Nga shitja e apartamentit</i>	-	<i>Kursime nga paga si prokuror të mbajtura në shtëpi. Vlera 250,000 lekë</i>	<i>Kursime nga paga si prokuror të mbajtura në shtëpi. Vlera 250,000 lekë</i>	-	<i>Kursime nga të ardhurat e pagës neto si prokuror për vitin 2014</i>	<i>Kursime nga të ardhurat e pagës neto si prokuror për vitin 2014</i>	-
Gjendje e akumuluar	3,000,000	3,000,000	3,250,000	3,500,000	3,500,000	4,200,000	4,550,000	4,550,000

**33.2** Veç sa më sipër, subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike 2012, vit në të cilin është blerë dhe deklaruar pasuria apartament me sip. 77.8 m<sup>2</sup>, nuk ka deklaruar burimin e krijimit të pasurisë dhe as pakësim të gjendjes *cash* të akumuluar deri më 31.12.2011, në shumën 3.500.000 lekë. Për rrjedhojë, deri në përfundim të hetimit administrativ Komisioni nuk mori në konsideratë në analizën financiare për blerjen e apartamentit objekt verifikimi të ardhurat nga shitja e apartamentit të mëparshëm në Elbasan prej 2.258.000 lekësh, mbartur si gjendje *cash* ndër vite.

**34.** Në përfundim të hetimit duket se ka deklarim të pasaktë të gjendjes *cash* në deklaratën *Vetting*, pasi subjekti nuk ka deklaruar gjendjen prej 4.550.000 lekësh në datën 31.12.2016, të provuar nëpërmjet deklarimeve periodike ndër vite. Sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me këtë konstatim.

**34.1** Në parashtrimet e tij, në lidhje me gjendjen *cash*, subjekti shpjegon se në procesverbalin e mbajtur nga ILDKPKI-ja në vitin 2015 ka deklaruar se në fund të vitit 2013 ka pasur gjendje *cash* në shumën 40.000 lekë. Në vijim të shpjegimeve, në parashtrime, subjekti shpjegon se në vitin 2012 ka shpenzuar të gjitha kursimet *cash* të krijuara në vite, si dhe arkëtimin e shumës *cash* nga shitja e apartamentit. Gjatë vitit 2014 ka deklaruar shtesë kursimesh *cash* në shumën 700.000 lekë dhe në vitin 2015 shtesë kursimesh *cash* në shumën 350.000 lekë, duke disponuar një gjendje të kursimeve *cash* në fund të vitit 2016 në shumën 1.090.000 lekë. Subjekti shpjegon se gjendjen *cash* në deklaratën *Vetting* nuk e ka deklaruar për shkak të një gabimi material, gabim i konstatuar gjatë vitit 2020 dhe për të cilin në datën 13.3.2020 ka paraqitur kërkesë pranë ILDKPKI-së, duke deklaruar se në deklaratën *Vetting* nuk kishte deklaruar për shkak të një gabimi material gjendjen *cash*, e cila në datën e dorëzimit të deklaratës *Vetting* ka qenë në shumën 1.090.000 lekë. Subjekti ka paraqitur kërkesën drejtuar ILDKPKI-së, faqen e deklaratës *Vetting* të korigjuar, si dhe konfirmimin nga posta shqiptare të shkresës së paraqitur pranë ILDKPKI-së. Ndërkohë, subjekti nuk ka vërtetuar me dokument zyrtar të lëshuar nga ILDKPKI-ja këtë pretendim. Ndër të tjera, në prapësime subjekti ka deklaruar se në deklaratën e vitit 2003 gjendja faktike *cash* ka qenë në shumën 742.000 lekë, shumë të cilën e ka pasqyruar edhe në analizën financiare, pavarësisht se në analizimin e gjendjes *cash* të paraqitur prej tij në formë tabelare gjendjen *cash* në vitin 2003 dhe deri në vitin 2009 e ka shënuar 0 (zero) lekë.

**34.2** Në vlerësim të parashtrimeve lidhur me gjendjen *cash*, Komisioni vlerëson se subjekti ka dhënë pjesërisht shpjegime. Konkretisht, shpjegimet e dhëna prej tij se në vitin 2003 gjendja *cash* është 742.000 lekë nuk qëndrojnë, pasi ky pretendim i subjektit nuk gjen pasqyrim në deklaratën e vitit 2003, në të cilën subjekti deklaroi në mënyrë të qartë se shuma e kursyer është 3.000.000 lekë. Lidhur me deklarimin se gjendja *cash* në datën 31.12.2013 është 40.000 lekë, Komisioni vlerëson se ky deklarim gjen pasqyrim edhe në procesverbalin e vitit 2015, të mbajtur në ILDKPKI dhe daton në një kohë kur nuk parashikohej procesi i *Vetting*-ut, por është në kuadër të shpjegimeve të dhëna në organin kompetent, në zbatim të ligjit nr. 9049/2003, në mënyrë të pavarur nga procesi i rivlerësimit. Për këtë arsye, Komisioni vlerëson të pasqyrojë në analizën e rishikuar financiare për vitin 2013 gjendje *cash* në vlerën 40.000 lekë, duke rezultuar në këtë mënyrë me gjendje *cash* më 31.12.2016 në shumën 1.090.000 lekë, sikurse subjekti ka pretenduar në parashtrime. Duke



qenë se kjo shumë nuk është pasqyruar në deklaratën *Vetting* të dorëzuar nga subjekti në vitin 2017, nga Komisioni vlerësohet si pasaktësi në deklaram.

**34.3** Bazuar në sa më sipër, sipas deklarimeve ndër vite, në vitin 2012 subjekti ka pasur gjendje *cash* në vlerën 3.500.000 lekë. Është e vërtetë që duke hequr nga kjo shumë vlerën 40.000 lekë, të konsideruar si gjendje *cash* në fund të vitit 2013, mbetet një shumë prej 3.460.000 lekësh, me të cilën nuk është vërtetuar të jetë blerë ndonjë pasuri. Por, duke qenë se në DPV-në për vitin 2012 subjekti nuk ka deklaruar pakësim likuiditeti në *cash* me qëllim blerjen e pasurisë objekt vlerësimi në lagjen “\*\*\*\*” dhe as të ardhura nga shitja e pasurisë apartament në lagjen “\*\*\*\*”, Elbasan, dhe në kushtet e kontraktave dhe paqartësive të përsëritura në deklaram, në përfundim të procesit Komisioni u është referuar deklarimeve ndër vite të subjektit dhe shuma 3.500.000 lekë, gjendje *cash* e mbartur deri në vitin 2012, nuk është konsideruar si burim për blerjen e apartamentit në lagjen “\*\*\*\*” .

**35.** Sa i takon burimit të dytë 476.719 lekë me të ardhura nga paga, rezulton se subjekti në deklaratën periodike të vitit 2012 nuk ka deklaruar pakësim të kursimeve *cash* të akumuluar deri më 31.12.2011, ku një pjesë e tyre janë me burim nga pagat ndër vite. Në këto kushte, në analizën e kryer nga Komisioni, si burim i krijimit të pasurisë do të merren në konsideratë vetëm të ardhurat nga pagat për periudhën 1.1.2012 – 25.9.2012 në shumën 856.208 lekë, të cilat pas zbritjes së shpenzimeve jetike për 9 muaj prej 418.644 lekësh, pagesave për shkollim prej 51.000 lekësh dhe 92.800 lekësh, përdorur për shtimin e pasurisë (shtuar automjet 100.000 lekë dhe pakësuar likuiditete 7.200 lekë), mbeten për t’u përdorur për blerjen e apartamentit vetëm 293.763 lekë.

#### **Analizë financiare për blerjen e pasurisë apartament në lagjen “\*\*\*\*”, Elbasan**

**36.** Në lidhje me mundësinë e blerjes së kësaj pasurie, nga analiza financiare, paraqitur si në tabelën më poshtë, duket se subjekti nuk ka pasur mundësi pagese me të ardhura të ligjshme për të paguar shumën 50.000 euro.

Përshkrimi	1.1.2012 – 25.9.2012
<b>Pasuritë</b>	<b>7,072,300</b>
Automjet “Mercedes-Benz 250D”, me targë ***	100,000
Apartament lagjja “****”	6,979,500
<i>Shtesa/pakësime likuiditetesh</i>	<i>-7,200</i>
<b>Të ardhurat</b>	<b>856,208</b>
Të ardhurat nga paga subjekti	856,208
Të ardhurat nga paga bashkëshortja e subjektit	0
<b>Shpenzimet</b>	<b>469,644</b>
Shpenzime jetike	418,644
Shpenzime shkollimi	51,000
Shpenzime udhëtimi TIMS	0
<b>Mundësia për kursime</b>	<b>-6,685,737</b>

**37.** Në përfundim të hetimit administrativ për apartamentin me numër pasurie \*\*\* në Elbasan, blerë në vitin 2012, duket se subjekti i rivlerësimi në deklaratën *Vetting*:

- Ka kryer deklarime të pasakta e të rremë sa i takon: (i) çmimit të shitjes, pasi çmimi i paguar për blerjen e pasurisë është 50.000 euro dhe jo 3.821.526 lekë, që është parashikuar në kontratën e shitjes, duke e bërë këtë një çmim fiktiv; (ii) burimit të krijimit të pasurisë, pasi si të tillë ka deklaruar të ardhura të përfituara nga kontrata e shitjes nr. \*\*\*/\*\*, datë 30.7.2010, në të cilën nuk ka qenë palë shitëse, ndërkohë që si në DPV-në për vitin 2010, ashtu dhe në DPV-në e vitit 2012 (që pretendon gjatë procesit), nuk ka deklaruar të ardhura nga shitja e ndonjë pasurie. Për me tepër, sipas një kontrate të vitit 2001, pasuria objekt i kësaj kontrate i ishte shitur EKB-së nga subjekti dhe të ardhurat e përfituara nga kjo shitje subjekti i ka deklaruar si gjendje *cash* në DPFV-në e vitit 2003;

- Subjekti i rivlerësimit ka mungesë burimesh të ligjshme për blerjen e pasurisë për shkak të balancës negative në shumën -6.685.737 lekë.

- Subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime kontradiktore e të paqarta në lidhje me apartamentin me nr. pasurie \*\*\* në Elbasan, për të cilin duket se ka veprime fiktive, të ardhurat nga shitja e të cilit i ka deklaruar si burim për blerjen e pasurisë objekt verifikimi.

**37.1** Për rrjedhojë, duket se subjekti nuk ka plotësuar kriteret e parashikuara në pikën 1 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 dhe pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe referuar parashikimeve në shkronjat a, b dhe ç të nenit 33 të ligjit ka kryer deklarime të pamjaftueshme në lidhje me këtë pasuri. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e këtyre konstatimeve, për të vërtetuar që nuk është në kushtet e pikës 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit dhe vlerësimi i Komisionit**

**38.** Në parashtrimet<sup>9</sup> e veta, në lidhje me çmimin e apartamentit subjekti pretendon se pa të drejtë nga Komisioni është konsideruar shuma 50.000 euro dhe si i tillë duhet konsideruar çmimi i parashikuar në kontratën e shitjes me datë 25.9.2012 në vlerën 3.821.526 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale, përpara hartimit të kontratës. Po kështu, subjekti parashtron se fakti që në përgjigje të pyetësorit nr. 1 ka paraqitur deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 4.6.2012, tregon se nuk kam pasur për qëllim të fsheh vlerën e apartamentit dhe të deklaroj një çmim fiktiv blerjeje pasi, nëse do të ishte kështu, nuk do ta kisha paraqitur dhe dorëzuar këtë deklaratë.

Sipas subjektit, shuma prej 3.821.526 lekësh i është dhënë shtetasit E. K. në këtë mënyrë: 15.000 euro i është dhënë në datën 27.6.2012 nëpërmjet transferimit, bashkë me vëllain P. A. , në nr. e llogarisë \*\*\* përfituesit \*\*\* dhe diferenca iu dha në lekë në momentin e kalimit të pronësisë, datë 25.9.2012. Subjekti arsyeton se ky akt bankar tregon qartësisht se kjo pagesë nuk po kryhej vetëm për apartamentin me nr. pasurie \*\*\* që ai do të blinte, por edhe për një pasuri tjetër që duhej të çlirohej, pasi mbahej e bllokuar nga banka (duket se është fjala për apartamentin tjetër, që subjekti ka pretenduar se do të blinte vëllai i tij).

Subjekti i rivlerësimit në mënyrë të paqartë shprehet se: *“Deklarata noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 22.9.2012, në të cilën deklarohet njohja e detyrimit prej 15.000 euro e shtetasit Petref Asllani ndaj E. K. , me qëllim realizimin përfundimtar të kontratës së shitjes së pasurisë apartament me sip. 77.8 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, lidhet me faktin se shtetasja E. K. kërkonte që shuma prej 15.000 euro e paguar, i përkiste apartamentit me nr. \*\*\* dhe jo vetëm apartamentit që do të blija unë, në këtë mënyrë kërkonte të sigurohej plotësisht për vlerën e apartamentit në shumën 3.821.526 lekë. Në lidhje me vlerën 50.000 euro e përmendur në deklaratën e datës*

<sup>9</sup> Subjekti ka paraqitur dokumentet e apartamentit me nr. pasurie \*\*\*, bashkëlidhur shkresës nr. \*\*\* prot., datë 30.4.2024, të ASHK-së Elbasan.

4.6.2012, kam sqaruar se kjo shumë nuk i përket vetëm blerjes së apartamentit nr. \*\*\*, por lidhet edhe me heqjen nga bllokimi që banka i kishte bërë apartamentit nr. \*\*\*”.

**38.3** Subjekti u referohet disa dispozitave ligjore të Kodit të Procedurës Civile, Kodit të Procedurave Administrative, ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, si dhe ligjit nr. 84/2016. Po kështu sjell në vëmendje vendimin nr. 1, datë 31.1.2019 të Kolegjit, që i referohet nenit 690 të Kodit Civil, sipas të cilit kontrata e lidhur rregullisht ka forcën e ligjit për palët dhe nenit 253 të Kodit të Procedurës Civile, i cili përcakton se “Aktet zyrtare që përpilohen nga nëpunësi i shtetit ose personi që ushtron veprimtari publike, brenda kufijve të kompetencës së tyre dhe në formën e caktuar, përbëjnë provë të plotë të deklaratimeve që janë bërë përpara tyre për faktet që kanë ngjarë në prani të tyre ose për veprimet e kryera prej tyre”, duke parashtruar se në kuadër të këtij procesi si Komisioni, ashtu dhe Kolegji, zbatojnë dispozita të Kodit të Procedurës Civile lidhur me fuqinë provuese të provave shkresore. Si përfundim, sipas subjektit, Komisioni duhet të përfshijë në analizën financiare çmimin e blerjes sipas kontratës së shitblerjes nënshkruar midis palëve, në shumën 3.821.526 lekë.

**38.4** Në analizë të parashtrimeve vlerësohet se subjekti nuk paraqiti prova dhe argumente bindëse për të provuar të kundërtën e barrës së provës në lidhje me çmimin e blerjes se pasurisë në vlerën 50.000 euro sipas deklaratës noteriale me datë 4.6.2012. Vetëm fakti që këtë akt subjekti e ka paraqitur vetë në pergjigje të pyetësorit standard, nuk e kundërshton përmbajtjen e saj.

Deklarata noteriale e datës 4.6.2012, në të cilën parashikohet shprehimisht çmimi i blerjes së pasurisë nga subjekti prej 50.000 euro, (pa u përmendur në asnjë moment vëllai i tij apo apartamenti i pretenduar se do të blihej prej këtij), nga të cilat 15.000 euro do të likuidoheshin me kalimin e pronësisë, është në koherencë të plotë me deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 22.9.2012, në të cilën deklarohet njohja e detyrimit prej 15.000 euro e shtetasit Petref Asllani me qëllim realizimin përfundimtar të kontratës së shitjes së pasurisë apartament me sip. 77.8 m<sup>2</sup>, me nr. pasurie \*\*\*, deklaratë në të cilën gjithashtu nuk është përmendur në asnjë moment emri i vëllait të subjektit apo një apartament tjetër që subjekti pretendon se që do të blihej prej tij. Pas tre ditësh, në datë 25.9.2012, është lidhur kontrata përfundimtare e shitjes objekt i të cilës është ekzaktësisht apartamenti nr \*\*\*, me numer pasurie \*\*\*, me sip. 77.8 m<sup>2</sup>, i përmendur në deklaratat noteriale të datave 4.6.2012 dhe 22.9.2012, kontratë ku çmimi i shitjes është ekzaktësisht sa çmimi i referencës, 3.821.526 lekë, rrethanë që se bashku me provat e sipërpërmendura përforcon bindjen se çmimi i shënuar në këte akt noterial nuk është çmimi real.

Në këto kushte, sikurse është vlerësuar edhe në përfundim të hetimit administrativ (arsyetuar në pikën 24 të këtij vendimi), në përfundim të procesit krijohet bindja se: (i) çmimi i blerjes së pasurisë është 50.000 euro sipas deklaratës noteriale me datë 4.6.2012 dhe deklaratimet e subjektit për një pasuri tjetër që do të blente vëllai i tij brenda këtij çmimi, janë përpjekje e dështuar e tij për të kundërshtuar këtë çmim për të cilin ka qenë në pamundësi financiare për ta paguar; (ii) subjekti ka nënshkruar një çmim fiktiv në kontratën e shitjes të datës 25.9.2012 prej 3.821.526 lekë; (iii) subjekti ka kryer deklaram të rremë të çmimit në deklaratën *Vetting*.

**39.** Në lidhje me burimin e krijimit, subjekti shpjegon se një nga burimet që shërbeu për blerjen e apartamentit me nr. \*\*\* janë të ardhurat nga shitja e apartamentit me nr. pasurie \*\*\* në lagjen “\*\*\*\*”, Elbasan, të cilat Komisioni nuk i ka marrë në konsideratë. Subjekti parashtron se ardhurat e përfituara nga shitja e këtij apartamenti prej 2.258.000 lekësh në vitin 2001 ia ka dhënë shtetasit Q. H.<sup>10</sup>, por pa formalizuar marrëdhënien e huas dhe, duke qenë se ky i fundit nuk ia ktheu këtë

---

<sup>10</sup> Subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 6.5.2024, të shtetasit Q. H., i cili deklaron se shumën prej 2.258.000 lekësh shtetasi Petref Asllani ia ka dhënë dorazi dhe se këtë shumë e ka përdorur për të blerë

shumë, edhe pas shitjes në vitin 2001 ai ishte pronari *de facto* i këtij apartamenti deri në momentin e shitjes tek shtetasi B. R. . Sipas tij, vlerën e shitjes së apartamentit e ka marrë nga shtetasi B. R. në dy këste, një këst i vogël rreth shumës 2.500 euro në vitin 2010, ndërsa pjesën tjetër e ka arkëtuar në vitin 2012. Në vijim të shpjegimeve, subjekti parashtron se në vitin 2012 shitjen e apartamentit në lagjen “\*\*\*\*” e ka deklaruar si burim për blerjen e apartamentit në lagjen “\*\*\*\*” , ashtu si dhe në deklaratën *Vetting*.

**39.1** Në analizë tërësore të të gjitha provave të administruara në raport me deklaratimet e subjektit ndër vite dhe gjatë procesit, rezulton se deklaratimet e subjektit që shuma e përfituar nga shitja e pasurisë në vitin 2001 i është dhënë hua shtetasit Q. H. dhe të ardhurat nga shitja e pasurisë në vitin 2012 nuk i ka marrë shtetasi Q. H. por i ka marrë vetë subjekti, mbeten të pavërtetuara me akte shkresore dhe bien në kundërshtim në jo pak raste me vetë deklaratimet e subjektit apo dokumenta shkresore të administruara. Konkretisht gjatë procesit subjekti nuk e ka përmendur huanë e dhenë shtetasit Q. H. , ndërkohë që ka deklaruar se shuma e përfituar nga shitja e pasurisë EKB-së Elbasan është lënë si garanci për dhënien e një kredie shtetasit Q. H. . Po kështu, në DPDF-në e vitit 2003 është deklaruar si gjendje *cash* në banesë shuma prej 3.000.000 lekë me të ardhura nga shitja e apartamentit në vitin 2001, pa u deklaruar huadhënia shtetasit Q. H. . Nga ana tjetër, kontrata e shitjes së pasurisë të shtetasit Besnik Raxha është e vitit 2010 dhe palë shitëse në këtë kontratë nuk është subjekti por shtetasi Q. H. . Për më tepër, është vërtetuar që subjekti ka kryer veprime fiktive si në blerjen, ashtu edhe në shitjen e pasurisë në lagjen “\*\*\*\*”. Në këto kushte, Komisioni ka qenë në vështirësi objektive për një rivlerësim sa më objektiv të te dyja pasurive të blera nga subjekti dhe për këtë arsye, në vlerësimin përfundimtar të burimeve që kanë shërbyer për blerjen e pasurisë në lagjen \*\*\*, iu referua saktësisht fakteve dhe rrethanave të rezultuara nga hetimi administrativ si vijojnë: (i) Në deklarin periodik të vitit 2012, kur është blerë pasuria, nuk rezulton që subjekti të ketë deklaruar të ardhura nga shitja e apartamentit në lagjen “\*\*\*\*” dhe as pakësim të likuiditeteve *cash*, si dhe nuk ka deklaruar burimin e krijimit të pasurisë; (ii) Subjekti e ka humbur pronësinë e apartamentit në lagjen “\*\*\*\*” që në vitin 2001 kur është vërtetuar që ka përfituar në rrugë bankare çmimin e shitjes së pasurisë dhe e ka deklaruar si gjendje likuiditeti në *cash* në banesë në DPDF 2003, dhe, për rrjedhojë, të ardhurat nga kontrata e shitjes së vitit 2010 me blerës B. R. , ku subjekti nuk është palë në kontratë, nuk mund të kenë shërbyer si burim; (iii) Nuk ka asnjë dokument ligjor provues, ku të konfirmohet se subjekti ka përfituar në vitin 2012 shumën 3.345.117 lekë nga shtetasi B. R. , pasi edhe në deklaratën noteriale të shtetasit B. R. nga ky i fundit nuk deklarohet që këtë shumë ia ka dhënë subjektit. Sa i takon deklarin se një pjesë e të ardhurave nga shitja e pasurisë shtetasit B. R. janë marrë në vitin 2010 dhe pjesa tjetër në vitin 2012, ky deklarim bie në kundërshtim me deklarin e subjektit, dhënë në ILDKPKI në vitin 2015, ku ka deklaruar se vlerën prej 3.345.117 lekësh ai e ka marrë nga shtetasi B. R. në vitin 2012, ndërkohë që as ky shtetas nuk e ka deklaruar një fakt të tillë në deklaratën noteriale të lëshuar prej tij në vitin 2014. Po kështu, nuk është i vërtetë deklarimi i subjektit në parashtrime se në DPV-në e vitit 2012 ka deklaruar shitjen e apartamentit në lagjen “\*\*\*\*” si burim për blerjen e apartamentit në lagjen “\*\*\*\*” .

**39.2** Bazuar në sa më sipër, Komisioni vlerësoi të mos i konsiderojë të ardhurat nga shitja e apartamentit me nr. pasurie \*\*\* si burim i ligjshëm për krijimin e apartamentit objekt verifikimi me nr. pasurie \*\*\*.

**40.** Në lidhje me mungesën e burimeve të ligjshme në shumën prej -6.685.737 lekësh për blerjen e apartamentit me nr. \*\*\*, subjekti kundërshton analizën e kryer nga Komisioni për vitin 2012 dhe pretendon se nuk ekziston gjendje likuiditeti e vënë në këtë vit në vlerën 3.511.754 lekë, pasi

---

apartamentin në Tiranë. Q. H. deklaron se apartamentin e lënë si garanci ia ka shitur shtetasit B. R. në vlerën 3.345.117 lekë dhe se këtë shumë shtetasi B. R. do t’ia jepte shtetasit Petref Asllani.

realiteti i gjendjes *cash* 3.000.000 lekë është deklaruar në vitin 2003, pra nuk është kursim i këtij viti. Po kështu pretendon se vlera e apartamentit është 3.821.526 lekë dhe jo 6.979.500 lekë dhe se, po të zbresësh vlerat e shtuara me të padrejtë 3.511.754 lekë dhe 3.157.279, në totalin prej 6.669.728 lekësh, nuk ka asnjë lloj pamjaftueshmërie në burimin e të ardhurave.

Për sa i përket gjendjes *cash* në vlerën 3.511.754 lekë, për të cilën subjekti pretendon se Komisioni e ka konsideruar pa të drejtë si pasuri të krijuar në vitin 2012, ky është një pretendim që nuk qëndron. Komisioni në analizën e tij për vitin 2012 ka përfshirë vetëm pakësimin e likuiditeteve në vlerën 5.572 lekë. Vlera prej 3.511.754 lekësh është gjendja e likuiditetit të krijuar ndër vite dhe e mbartur deri në vitin 2012, e pashpenzuar për blerjen e apartamentit, pasi subjekti nuk ka deklaruar në deklaratën e vitit 2012 pakësimin e likuiditetit. Në këto kushte, subjekti nuk arriti të provojë të kundërtën e barrës së provës së dërguar nga Komisioni.

**41.** Për sa i përket konstatimit se *subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime kontradiktore e të paqarta në lidhje me apartamentin me nr. pasurie \*\*\* në Elbasan, për të cilin duket se ka veprime fiktive, të ardhurat nga shitja e të cilit i ka deklaruar si burim për blerjen e pasurisë objekt verifikimi*, subjekti është përpjekur të argumentojë se ka kryer gjithmonë deklarime të sakta, ndërkohë që ky pretendim është i pabazuar referuar gjithë deklarimeve të tij në raport me aktet shkresore të administruara. Bazuar në të gjitha provat e administruara, sikurse është arsyetuar më sipër në këtë vendim, subjekti nuk ka mundur të kundërshtojë faktin se ka kryer veprime fiktive, pasi: (i) çmimi i blerjes së pasurisë në lagjen “\*\*\*\*” prej 300.000 lekësh u vërtetua të ketë qenë fiktiv; (ii) në deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 9.11.2011, vetë subjekti deklaroi se apartamentin në lagjen “\*\*\*\*” ia ka shitur formalisht EKB-së në vitin 2001; (iii) nga tërësia e veprimeve të kryera dhe faktit që subjekti ka vijuar të përdorë apartamentin në lagjen “\*\*\*\*” edhe pasi ia ka shitur EKB-së në vitin 2001 deri në vitin 2012, duket se shitja e kësaj pasurie është bërë formalisht, pasi subjekti *de facto* nuk e ka humbur pronësinë mbi të dhe shitja e pasurisë është bërë pikërisht me qëllimin e marrjes së një kredie nga ana e shtetasit Q. H. . Për më tepër, veprimet fiktive kanë vijuar nga ana e subjektit të rivlerësimit pasi subjekti ka nënshkruar kontratën e blerjes së pasurisë në lagjen \*\*\* në datë 25.9.2012, në të cilën çmimi i blerjes së pasurisë prej 3.821.526 lekë u vërtetua të jetë një çmim fiktiv.

Bazuar në sa më sipër, subjekti ka kryer veprime fiktive, deklarime të reme e të pamjaftueshme si për pasurinë objekt vlerësimi të deklaruar në deklaratën *Vetting*, apartament në lagjen “\*\*\*\*”, ashtu dhe për apartamentin në lagjen “\*\*\*\*”, të ardhurat nga shitja e të cilit janë deklaruar si burim për blerjen e tij, duke qenë në kushtet e nenit 61/3 të ligjit 84/2016.

**42.** Subjekti ka deklaruar: *“Tokë bujqësore dhe truall, nga e cila 8.250 m<sup>2</sup> tokë arë dhe 200 m<sup>2</sup> tokë truall, fshati \*\*\*, njësi administrative \*\*\*, bashkia \*\*\*, e përfutuar nga ligji nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën” si anëtar i familjes bujqësore me përfaqësues D. A. Sipas dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. \*\*\*/\*\*\*, datë 25.2.2014, trashëgimtarë të D. dhe E. A. janë: M. H. (A.), Q. S. (A.), H. M. (A.), F. A., P. A., A. V. (A.), S. A., Y. A., Q. A., nga \*\*\* pjesë, dhe Petref Asllani \*\*\* pjesë. Trualli prej 200 m<sup>2</sup> zënë me ndërtim (ngrehinë bujqësore) nga trashëgimtari Q., pa pëlqimin e bashkëtrashëgimtarëve. Burimi i krijimit: zbatimi i ligjit nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”. Zotëron: 39.3%”.*

**42.1.** ILDKPKI-ja në lidhje me këtë pasuri ka konstatuar: konfirmohen nga ZVRPP pasuritë e përfutuar nga subjekti me dëshmi trashëgimie ligjore nga prindërit, të cilët i kishin përfutuar me ligjin nr. 7501 “Për tokën”. Subjekti ka deklaruar pjesën takuese të tokës së përfutuar me ligjin nr. 7501 si anëtar i familjes bujqësore, në deklaratën “Për herë të parë 2003”. Në vitin 2014 e në vijim nuk ka përcaktuar përfitimin me trashëgimi ligjore nga prindërit të tokës bujqësore (nga ligji nr.

7501) 8.280 m<sup>2</sup> dhe tokës truall 200 m<sup>2</sup> në fshatin \*\*\*, Njësia Administrative \*\*\*, bashkia \*\*\*, ku subjekti zotëron 39.3%.

**42.2.** Në lidhje me këtë pasuri për të cilën në deklaratën *Vetting* subjekti ka deklaruar se mbi truallin prej 200 m<sup>2</sup> ka një ndërtim që përdoret si ngrëhinë bujqësore nga vëllai i tij Q.A., u konstatua se:

- Sipas informacionit të ZVRPP-së Elbasan, shtetasi Petref Asllani është bashkëpronar me \*\*\* pjesë takuese në pasuritë e ndodhura në fshatin \*\*\*, Elbasan, z.k. \*\*\*, si vijojnë: pasuria nr. \*\*\* e llojit arë me sip. 870 m<sup>2</sup>; pasuria nr. \*\*\* e llojit arë me sip. 3 300 m<sup>2</sup>; pasuria nr. \*\*\* e llojit arë me sip. 2850 m<sup>2</sup>; pasuria nr. \*\*\* e llojit arë me sip. 1260 m<sup>2</sup>; pasuria nr. \*\*\* e llojit truall me sip. 200 m<sup>2</sup> dhe ndërtesë me sip. 110 m<sup>2</sup>.

- ALUIZNI, në dosjen ILDKPKI, si dhe ASHK Elbasan kanë informuar se nuk figuron të jenë aplikues për vetëdeklarime në objekte informale. FSHU-ja nuk ka konfirmuar kontratë të furnizimit me energji në emër të subjektit në fshatin \*\*\*. UK Elbasan, përveç kontratës së apartamentit objekt verifikimi në Elbasan, nuk ka konfirmuar kontratë tjetër.

**42.3.** Komisioni verifikoi origjinën dhe mënyrën e krijimit të pasurisë në raport me deklaratimet e subjektit dhe, pas administrimit të disa dokumenteve shkresore pasqyruar në mënyrë të detajuar në rezultatet e hetimit administrativ, në përfundim të hetimit administrativ nuk u konstatuan problematika në lidhje me këtë pasuri të përfituar nga ligji nr. 7501, datë 19.7.1991 “Për tokën” dhe nuk u vërtetuan kontribute të subjektit në ndonjë investim mbi të.

**43.** Subjekti ka deklaruar: *“Autoveturë tip “Mercedes-Benz” me targë \*\*\*, prodhim i vitit 1992, blerë në datën 16.4.2012. Vlera: 100.000 lekë. Zotëron: 100%. Burimi i krijimit: të ardhurat nga paga”*. ILDKPKI-ja në lidhje me këtë pasuri nuk ka konstatuar problematika.

**43.1.** Pasi u verifikua origjina e mjetit, u vërtetua se me kontratë shitblerjeje nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\*kol., datë 16.4.2012, subjekti Petref Asllani ka blerë nga shitësi T. R. automjetin tip “Mercedes-Benz”, me targë \*\*\*, në çmimin 100.000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale. Në DPV-në e vitit 2012 subjekti ka deklaruar blerjen e këtij automjeti, por pa deklaruar burimin e krijimit, automjet të cilin e ka shitur me kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 11.9.2021, në shumën 80.000 lekë shtetases A. B. Po kështu, gjatë hetimit administrativ rezultoi se:

Nga verifikimi në sistemin e AMF-së, mjeti me targë \*\*\* në periudhën 26.3.2008 – 25.3.2010 figuron në pronësi të shtetasit T. R.<sup>11</sup> dhe përdorues Petref Asllani; Në sistemin TIMS nuk rezulton që subjekti apo ndonjë nga familjaret të kenë përdorur këtë automjet; Shtetasi T. R. nuk rezulton të ketë përdorur këtë automjet sipas sistemit TIMS; Në periudhën nga 28.4.2010 deri në datën 8.7.2021 mjeti figuron me pronar shtetasin Petref Asllani; Në periudhën 1.9.2021 – 9.9.2022 mjeti figuron në pronësi të subjektit dhe me përdorues shtetasit F. Gj. dhe A. B.; Në periudhën 12.8.2023 – 11.8.2024 mjeti figuron me pronar dhe përdorues vetëm subjektin.

Në deklaratën *Vetting*, si burim krijimi të kësaj pasurie subjekti ka deklaruar të ardhurat nga paga. Nga analiza financiare e paraqitur rezulton se subjekti ka pasur mundësi për blerjen e tij. Edhe nëse analiza financiare e subjektit do të bëhej në datën 26.3.2008 (momenti kur figuron përdorues i rregullt), ajo do të rezultonte me balancë pozitive dhe, për rrjedhojë, subjekti do të kishte mundësi për ta blerë mjetin me të ardhura të ligjshme.

**43.2.** Në përfundim të hetimit administrativ, sipas të dhënave të AMF-së subjekti e ka përdorur mjetin që në vitin 2008, ndërkohë që e ka blerë në vitin 2012, dhe në përgjigje të pyetësorit standard

---

<sup>11</sup> Nuk rezultuan të dhëna për konflikt interesi me këtë shtetas.

nuk e ka deklaruar këtë fakt. Po ashtu e ka përdorur edhe pas shitjes në shtator të vitit 2021. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime në lidhje me këto konstatime.

**43.3.** Në parashtrime fillimisht subjekti jep shpjegimet e tij në lidhje me konceptet ligjore të termave juridikë “pronësi”, “posedim” dhe “përdorim”. Më tej, subjekti sqaroi se nuk ka kryer lëvizje të shpeshta me këtë mjet. Sipas tij, duke qenë se edhe nga hetimi nuk ka dyshime për pasuri të fshehur, pasi u provua burimi i ligjshëm i krijimit, edhe nëse Komisioni jep një vlerësim ndryshe konceptit të tij ligjor mbi atë çfarë quhet/konceptohet pasuri në përdorim, sikurse parashtrroi më sipër, sipas tij kjo rrethanë nuk mund të konsiderohet e qëllimshme, përderisa nuk arrihet të vërtetohet se mund të kemi të bëjmë me fshehje të burimit të ligjshëm apo fshehje të pasurisë, apo përpjekje të tij për të mos e deklaruar/fshehur atë.

**43.4.** Në lidhje me konstatimin se në përgjigje të pyetësorit standard nuk e ka deklaruar këtë fakt, subjekti parashtron se ky konstatim është i drejtë, por nisur nga fakti se automjeti ishte deklaruar në ILDKPKI që nga viti 2012 dhe në deklaratën *Vetting* ishte pasqyruar saktësisht si pasuri e tij, në vlerësimin e tij ligjor ky send nuk do të duhej të deklarohet si pasuri në përdorim, përderisa ishte deklaruar në pronësi të tij.

**43.5.** Lidhur me konstatimin e Komisionit se subjekti e ka përdorur automjetin edhe pas shitjes në shtator të vitit 2021, subjekti parashtrroi se që në muajin korrik të vitit 2021 ai si pronar i automjetit kishte blerë në kompaninë siguroese siguracionin e tij me afat njëvjeçar. Në muajin shtator, pronari i ri i mjetit, pasi ka kryer në DRSHTRR-në Elbasan veprimet për kalimin në pronësi, nuk është paraqitur në kompaninë siguroese për të kryer veprimet ligjore dhe bërë shënimet në lidhje me ndryshimin e pronësisë në policën e sigurimit, në të tilla rrethana për kompaninë siguroese subjekti ka figuruar si pronar i mjetit edhe pas shitjes së tij. Ndërkohë del qartë dhe nuk ka asnjë provë që subjekti ta ketë përdorur automjetin pas shitjes së tij. Subjekti ka paraqitur disa dokumente, si policën e sigurimit për periudhën 12.8.2023 – 11.8.2024, ku figurojnë emrat e shtetasve F. Gj. dhe A. B. dhe nuk figuron emri i subjektit.

**43.6.** Në analizë të parashtrimeve të subjektit konstatohet se vetë subjekti e pranon faktin se e ka përdorur automjetin para se të fitonte pronësinë e tij, si dhe faktin që në pyetësorin standard ai duhej ta deklaronte përdorimin e tij, por nga ana tjetër subjekti nuk dha shpjegime të plota dhe të qarta se përse ai e ka përdorur gjatë kohës që nuk e kishte në pronësi. Sa i takon përdorimit të mjetit pas shitjes së tij, sqarimet e subjektit vlerësohet se qëndrojnë.

**44.** Bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. N. A., ka plotësuar autorizimin dhe ka deklaruar se nuk disponon pasuri të regjistruar veçmas. As nga aktet e ndodhura në dosjen ILDKPKI dhe as nga hetimi nuk rezultojnë pasuri në emër të shtetasës N. A. Në deklaratën *Vetting*, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar vetëm të ardhura si punëtore pranë personit juridik/fizik “\*\*\*\*” me NIPT \*\*\*.

**45.** Djali i subjektit të rivlerësimit – A. A. ka plotësuar autorizimin dhe ka deklaruar se nuk disponon pasuri të regjistruar veçmas. Nga aktet e ndodhura në dosjen ILDKPKI dhe gjatë hetimit nuk rezultojnë pasuri në emër të shtetasit A. A. Në deklaratën *Vetting* ka deklaruar vetëm të ardhurat si punëtor tek personi juridik/fizik \*\*\* me NIPT \*\*\*; \*\*\* me NIPT \*\*\*; \*\*\* me NIPT \*\*\*.

**46.** Vajza e subjektit të rivlerësimit – K. A. ka plotësuar autorizimin dhe ka deklaruar se nuk disponon pasuri të regjistruar veçmas. Nga aktet e ndodhura në dosjen ILDKPKI dhe nga hetimi nuk rezultojnë pasuri në emër të K. A.

### **Analiza financiare për periudhën e rivlerësimit**

**47.** Nga analiza e deklaratave të interesave pasurorë privatë/vjetorë dhe asaj *Vetting* për periudhën kur subjekti ka qenë në detyrë, vitet 1995 – 2016, të kryer nga Komisioni, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshortja e tij nuk kanë pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme në shumën – 10.003.034 lekë për të paguar shpenzimet dhe krijuar pasuritë. Subjektit i kaloi barra e provës për të provuar të kundërtën e rezultatit të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

Në parashtrimet e veta, subjekti ka kundërshtuar barrën e provës për mungesën e burimeve të ligjshme që kanë shkaktuar balancën negative, duke pretenduar në mënyrë të përmbledhur se:

- Në vitin 2003 duhet të përfshihen të ardhurat e dhuruara nga vëllai i tij Q. A. në shumën 300.000 lekë, me burim nga shitja e apartamentit në Elbasan në shumën 400.000 lekë, apartament i përdorur nga subjekti nga momenti i blerjes deri kur është shitur.

- Shpenzimet e jetesës deri në vitin 1999 duhet të përfshihen në masën 30% të të ardhurave, pasi të ardhurat vjetore kanë qenë mbi 800 USD/viti.

- Çmimi i blerjes së pasurisë apartament në lagjen “\*\*\*\*”, Elbasan, në vitin 2000, nuk duhet konsideruar 2.258.000 lekë, por 300.000 lekë sipas kontratës së shitblerjes.

- Gjendja *cash* në fund të vitit 2003 duhet të përllogaritet në shumën 742.000 lekë, aq sa kanë qenë kursimet nga paga deri në datën 31.12.2003.

- Gjendja *cash* në fund të çdo viti, bazuar në sqarimet dhe faktet e paraqitura, duhet të përfshihet në analizën financiare sipas tabelës së paraqitur në prapësime.

- Çmimi i blerjes së apartamentit në vitin 2012 duhet të përfshihet në analizën financiare, në shumën 3.821.526 lekë.

- Në lidhje me shpenzimet e udhëtimit, subjekti ka depozituar dokumentacion<sup>12</sup> provues lidhur me shpenzimet e udhëtimit të djalit për periudhën 16.3.2015 – 28.3.2015.

Në përfundim, subjekti shpjegon se pas marrjes në konsideratë për sa shpjeguar më sipër, analiza financiare rezulton me balanca negative në shumën -123.676 lekë për vitin 2013 dhe në shumën -152.360 lekë për vitin 2014, balanca këto që bazuar në parimin e proporcionalitetit nuk përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore.

Në vlerësim të parashtrimeve të subjektit, analizuar rast pas rasti në këtë vendim, më sipër janë trajtuar hollësisht pretendimet që nuk janë marrë në konsideratë. Ndërkohë, janë marrë në konsideratë pretendimet për shpenzimet e jetesës për periudhën deri në vitin 1999, duke pasqyruar në analizën e rishikuar vlerën e shpenzimeve për periudhën deri në vitin 2003 në shumën 1.929.695 lekë, nga 2.306.811 lekë që ishte në rezultatet e hetimit. Po kështu, në analizën financiare u pasqyrua pakësimi i shpenzimeve të udhëtimit sipas sistemit TIMS të djalit A., duke përfshirë vlerën e deklaruar prej subjektit në pyetësor dhe shpenzimi i rishikuar për vitin 2015 është në shumën 41.184 lekë, nga 82.368 lekë e përllogaritur në rezultatet e hetimit. Pas rishikimit të analizës financiare, subjekti dhe personat e lidhur me të rezultojnë me mungesë burimesh të ligjshme në shumën 9.502.242 lekë, nga 10.003.034 lekë që ishte në rezultatet e hetimit administrativ.

Edhe nëse në një qëndrim garantist në raport me pretendimet e subjektit të rivlerësimit, në analizën financiare të rishikuar do të merreshin në konsideratë pretendimet sa i takon çmimit të blerjes së apartamentit në lagjen “\*\*\*\*” në vitin 2001 në vlerën 300.000 lekë si dhe pretendimet në lidhje me të ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj pasurie duke i konsideruar ato si burim për blerjen e pasurisë në lagjen “\*\*\*\*” në vitin 2012 në vlerën 50,000 euro, rezultati do të ishte me një balancë

---

<sup>12</sup> Deklaratë noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 28.4.2024, e shtetases V. Rr.



negative të burimeve të ligjshme në shumën -2.838.429 lekë, e cila së bashku me pasaktësitë, mospërputhjet në deklarime, deklaramet e rreme si dhe veprimet fiktive të rezultuara në përfundim të procesit, do të përbënin shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra për shkak se subjekti ka kryer deklarime të pamjaftueshme në lidhje me kriterin pasuror sipas parashikimit të nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016.

## KONTROLLI I FIGURËS

**48.** Autoriteti Kombëtar për Sigurinë e Informacionit të Klasifikuar (AKSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim, AKSIK-ja ka dërguar raportin nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Petref D. Asllani, i deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 16.2.2022, të KDZH-së, nga ku rezulton se: (i) formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara nga vetë ai në deklaratën për kontrollin e figurës; (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të kimit të organizuar.

Në vijim të këtij raporti përshkruhet se bazuar në parashikimet e nenit 39, pika 2, subjekti ka pasaktësi në plotësimin e deklaratës për kontrollin e figurës (nuk ka deklaruar procedimin penal të parashikuar në nenin 257/a të Kodit Penal). Informacionet e ardhura nga institucionet verifikuese bëjnë me dije se: *“Në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan, në ngarkim të Petref D. Asllanit është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*, datë 3.4.2015, për veprën penale “Refuzimi për deklarimin, mosdeklarimin, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurive të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose i çdo personi tjetër që ka detyrimin për të deklaruar”, parashikuar nga neni 257/a i Kodit Penal. Ky procedim penal në datën 4.6.2015 është dërguar për gjykim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë (çështja vazhdon të jetë ende në gjykim)”*.

Për sa më sipër, Grupi i Punës ka konstatuar se: (i) Mosdeklarimi nga ana e subjektit të rivlerësimit për procedimin penal në ngarkim të tij e ngarkon z. Petref Asllani me përgjegjësinë e fshehjes së fakteve dhe të plotësimit të pasaktë dhe me vërtetësi të deklaratës për kontrollin e figurës (neni 39, pika 2); (ii) Në këndvështrimin e përgjithshëm të kontrollit apo pastërtisë së figurës së një funksionari publik, në rastin konkret për Petref D. Asllanin në cilësinë e prokurorit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Elbasan, çdo dyshim i arsyeshëm për kryerje ose moskryerje të veprimeve, në kundërshtim me ligjin, në mospërmbushje të rregullt të detyrës dhe kur këto veprime apo mosveprime sjellin përfitime materiale ose jomateriale të padrejta për vetë atë si funksionar publik apo persona të lidhur me të, cenojnë figurën e tij, shkallën e besueshmërisë dhe e bëjnë këtë individ të mundshëm për t’u vënë nën presion nga strukturat kriminale, sipas përcaktimit të shkronjës “c” të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016. Në konkluzion, AKSIK-ja ka konstatuar papërshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, z. Petref D. Asllani.

Pasi është administruar informacioni nga SHISH-i dhe është kryer verifikimi i këtyre informacioneve, nga ana e trupit gjykues është kërkuar nga AKSIK-ja përditësimi i raportit të mëparshëm, si dhe deklasifikimi i tij nëse ka informacione shtesë.

Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.4.2024, është përcjellë raporti i dytë me datë 29.3.2024, i deklasifikuar pjesërisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 2.4.2024, duke u shprehur: *“Në konfirmim të*

*konstatimit fillestar për përshtatshmëri për vijimin e ushtrimit të detyrës, gjykojmë që për rastin në fjalë konkluzioni të mbetet në vlerësimin e Komisionit nën dritën e informacioneve... ”.*

Siç vërehet, në këtë raport të dytë, si në pikën 1 të përshkrimit të fakteve, ashtu dhe në përfundim, grupi i punës është shprehur në mënyrë të gabuar se raporti fillestar ka qenë për përshtatshmëri, pasi raporti fillestar, ai i datës 2.11.2017, në përfundim është shprehur për papërshtatshmëri për vijimin e ushtrimit të detyrës.

SPAK-u ka informuar se pas verifikimeve në ish-Prokurorinë pranë Gjykatës për Krimet të Renda, rezulton se ndaj shtetasit Petref Asllani është regjistruar kallëzimi nr. \*\*\* dhe pas verifikimeve është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\* për veprën penale të parashikuar nga neni 319/ç, pa emër të regjistruar. Pas kryerjes së hetimeve të këtij procedimi, çështja është dërguar për kompetencë në Prokurorinë e Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar dhe është regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*, datë 20.12.2019, për veprën penale të parashikuar nga neni 319/ç, pa emër të regjistruar. Pas kryerjes së hetimeve në lidhje me procedimin nr. \*\*\* është vendosur shpallja e moskompetencës dhe kalimi i akteve në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Në përfundim nuk rezultoi që në emër të shtetasit Petref D. Asllani të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.

Subjektit i është kërkuar të japë sqarime në lidhje me konstatimet e grupit të punës në raportin e datës 2.11.2017. Në parashtrime, subjekti sqaron se në rastin e tij grupi i punës në vlerësimin e përgjithshëm për përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës është nisur vetëm nga fakti se ndaj tij është filluar një procedim penal, duke e vlerësuar se ka cenuar figurën, shkallën e besueshmërisë dhe e bën atë individ të mundshëm për t’u vënë nën presion nga strukturat kriminale, sipas përcaktimit të shkronjës “c” të nenit 37 të ligjit nr. 84/2016. Subjekti parashtron se ky konkluzion mbi vlerësimin e përgjithshëm të përshtatshmërisë së tij duket se është arritur në mungesë të informacioneve të përditësuara dhe, konkretisht, faktit se pas një kallëzimi abuziv të bërë nga ILDKPKI-ja subjekti ka ndjekur rrugën gjyqësore për pafajësinë e tij. Sipas subjektit, kallëzimi i këtij institucioni ndaj tij është një fakt i njohur publikisht, për të cilin ka dhënë sqarime sa herë i janë kërkuar, dhe se ai është në kushtet kur ka plotësuar saktësisht formularin. Subjekti arsyeton se nuk ka asnjë arsye pse të mos e shënonte këtë fakt në formularin e deklaratimit në lidhje me figurën. Nuk ka pasur asgjë që mund të fshihej apo që mund të imagjinonte se mund të fshihej, pasi ky kallëzim penal është iniciuar nga ILDKPKI-ja, pra ky informacion ishte lehtësisht i konfirmuar për Komisionin. Po kështu, nga gjykatat janë zhvilluar seanca publike për gjykimin e çështjes penale në ngarkim të tij. Çështja është bërë mediatike dhe me vendim gjyqësor përfundimtar është deklaruar i pafajshëm. Sipas subjektit, standardet e kontrollit të figurës përcaktohen nga neni 38 i ligjit nr. 84/2016 dhe se rrethanat që merren parasysh në konstatimin se formulari i deklaratimit nuk është i plotë dhe i besueshëm, përcaktohen në pikën 6 të këtij neni.

*Subjekti argumenton se ai nuk ka pasur pasaktësi në plotësimin e deklaratës për kontrollin e figurës dhe se, në rubrikat e deklaratës për kontrollin e figurës kërkohet deklarimi nëse je dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë ose dhe me vendim jopërfundimtar nga autoritetet gjyqësore vendëse apo të huaja dhe, po kështu, kërkohet informacion nëse keni qenë në hetim apo në procedura gjykimi nga një autoritet i huaj, si dhe realizimi i kontakteve me persona të përfshira në krimin e organizuar. Pra, në rubrikat e këtij formulari nuk kërkohet informacion nëse je apo jo në proces hetimi në Shqipëri. Kjo është arsyeja pse ky fakt nuk është shënuar në formular. Kjo është dhe arsyeja që AKSIK-ja në raportin e dytë, dërguar me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.4.2024, nuk i referohet më një fakti të tillë, pasi, duke vlerësuar praktikën e Komisionit dhe Kolegjit një informacion i tillë nuk kërkohet në formular dhe nuk përbënte pasaktësi.*

Sipas subjektit, në të dyja raportet që AKSIK-ja ka dorëzuar në Komision, nuk referohen dyshime për akte korruptive me persona që përfshihen në krimin e organizuar, sipas përcaktimeve të pikave 6, 8 e 15 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016. AKSIK-ja në analizën dhe arsyetimin mbi kriterin e kontrollit të figurës nuk rendit dhe nuk arsyeton mbi asnjë nga parashikimet e nenit 38 të ligjit nr. 84/2016 dhe në mënyrë të gabuar referon tek neni 37, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016. Sipas subjektit, përfundimet e grupit të punës në raportin e datës 2.11.2017 nuk janë të mirargumentuara dhe në përputhje me standardet e kontrollit të figurës dhe, për pasojë, nuk gjenden të mbështetura në ligj dhe në rubrikat që përmbaheshin në formularin e plotësuar dhe dorëzuar mbi kontrollin e figurës. Bashkëlidhur subjekti ka paraqitur kopje të formularit. Po kështu, thekson që në kohën e deklarimit ka marrë vendim pafajësie. Subjekti paraqiti dhe tri vendimet gjyqësore me anë të të cilave është shpallur i pafajshëm. Si përfundim, në lidhje me kriterin e pastërtisë së figurës, referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit pretendon se ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

Në analizë të parashtrimeve dhe dokumenteve të paraqitura nga subjekti, nga ana e Komisionit vlerësohet se ato qëndrojnë, duke u nisur nga faktet dhe rrethanat si vijojnë:

- Me vendimin nr. \*\*\*, datë 23.5.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është vendosur deklarimi i pafajshëm i të pandehuri Petref Asllani, i akuzuar për veprën penale “Refuzimi për deklarim, mosdeklarim, fshehja ose deklarimi i rremë i pasurisë, interesave privatë të personave të zgjedhur dhe nëpunësve publikë ose çdo personi tjetër që ka detyrim për deklarim”, parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal. Ky vendim është lënë në fuqi me vendimin nr. \*\*\*, datë 13.7.2017, të Gjykatës së Apelit Tiranë.

- Në deklaratën për kontrollin e figurës subjekti nuk ka deklaruar procedimin penal në ngarkim të tij për veprën penale të parashikuar nga neni 257/a/2 i Kodit Penal. Por, sipas legjislacionit të kohës në fuqi, kjo vepër penale nuk përfshihet në ato vepra penale të parashikuara në pikën 1 të nenit 3 të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar, për të cilën subjekti referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës, ligjit nr. 84/2016 dhe formularit për kontrollin e figurës do të duhej ta deklaronte. Nga ana tjetër, ky fakt del i qartë edhe nga vetë raporti i datës 2.11.2017 mbi kontrollin e figurës se subjektit të rivlerësimit Petref D. Asllani, ku grupi i punës ka konstatuar se formulari i deklarimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016, ndërsa në përfundim, në mënyrë kontradiktore ka konkluduar se mosdeklarimi nga ana e subjektit të rivlerësimit për procedimin penal në ngarkim të tij e ngarkon z. Petref Asllani me përgjegjësinë e fshehjes së fakteve dhe të plotësimit të pasaktë dhe me vërtetësi të deklaratës për kontrollin e figurës (neni 39, pika 2).

Sa më sipër, në procesin e vlerësimit përfundimtar të kriterit të figurës, ndryshe nga konstatimi fillestar i grupit të punës të AKSIK-së, Komisioni nuk evidentoi prova, fakte dhe rrethana që cenonjë figurën e subjektit të rivlerësimit për shkak të veprimtarisë korruptive apo kontakteve me persona të përfshirë në krimin e organizuar, apo mosplotësimit të pasaktë të deklaratës për kontrollin e figurës, duke çmuar se subjekti i rivlerësimit Petref Asllani ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.

## **VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

**49.** Në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, është bërë rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit Petref Asllani bazuar në raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë me nr. \*\*\* prot., datë 28.9.2023, protokolluar nga Komisioni me nr. \*\*\* prot., datë 10.10.2023; informacionin e marrë nga burime

të ligjshme; kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**50.** Raporti për analizimin e aftësive profesionale kryer nga KLP është bazuar në: (i) formularin e vetëdeklarimit, 3 dokumentet ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë atë; (ii) 5 dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga burimet arkivore të KLD-së.

Ne përfundim, bazuar në kriteret ligjore të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar pozitivisht për aftësitë profesionale, aftësitë organizative, etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale dhe për aftësitë personale dhe angazhimin profesional.

### **Informacioni i marrë nga burime të ligjshme**

**51.** Komisioni analizoi tri vendimet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë çështjet e shortuara sipas nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, nga analiza e të cilave rezultuan të njëjtat gjetje të konstatuara edhe nga KLP-ja në raportin e saj.

**52.** Në adresë të subjektit janë paraqitur shtatë denoncime nga publiku pas analizimit të të cilave për një prej tyre subjektit i janë kërkuar sqarime. Konkretisht, në denoncimin e tij shtetasi Kujtim Bakalli ngre pretendime ndaj prokurorëve të Elbasanit në lidhje me vendimet e mosfillimit të marrë nga pesë prokurorë, përfshirë edhe subjektin e rivlerësimit. Bashkëlidhur janë paraqitur disa dokumente dhe një video e emisionit investigativ “\*\*\*\*”, ndër to edhe vendimi datë 13.2.2023 për mosfillimin e procedimit penal të materialit kallëzues nr. \*\*\*, datë 26.1.2023, dhënë nga subjekti i rivlerësimit.

Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektin iu kërkuar të japë sqarime në lidhje me pretendimet e denoncuesit, si dhe të informojë mbi statusin e këtij vendimi, shoqëruar me dokumentacion provues.

Në parashtrimet e tij, subjekti sqaroi se pasi ka studiuar dhe marrë në shqyrtim të gjitha aktet, në zbatim të kërkesave ligjore të parashikuara nga neni 290/1, shkronja “ç” dhe neni 291 i Kodit të Procedurës Penale, me vendimin e datës 13.2.2023 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal. Ky vendim i është njoftuar kallëzuesit me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 7.3.2023, dhe kundër këtij vendimi kallëzuesi nuk ka ushtruar ankim, fakt i provuar edhe me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.4.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan. Sipas subjektit, vendimi mbi mosfillimin e procedimit penal është një vendim i bazuar në prova dhe në ligj. Referuar përmbajtjes së kallëzimit penal, akteve që i bashkëlidheshin kallëzimit penal, si dhe dokumenteve shkresore të dorëzuara nga përfaqësuesi i palës që pretendohet se mbante pronën me të padrejtë, rezultonte se nuk kishte të dhëna apo *indicie* për regjistrim procedimi penal. Fakti që edhe kallëzuesi ka hequr dorë nga e drejta e pretenduar prej tij duke mos ankimuar vendimmarrjen e Prokurorisë, është një tregues shtesë për vendimmarrje të bazuar në ligj dhe në prova.

Në mbështetje të sqarimeve, subjekti ka paraqitur: shkresën e prokurorisë datë 7.3.2023 për dërgimin e vendimit të mosfillimit të procedimit penal, drejtuar shtetasit K. B.; fletë nga regjistri “për dërgim vendim pushimi, mosfillimi, pezullimi”, ku figuron i regjistruar mosfillim me nr. rendor \*\*\*, \*\*\*/\*\*\*; shkresë datë 26.4.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, sipas së cilës shtetasi K. B. nuk ka paraqitur ankim ndaj vendimit të mosfillimit për materialin kallëzues nr. \*\*\* regj., datë 26.1.2023.

Në analizë të parashtrimeve dhe provave të paraqitura, nga ana e Komisionit vlerësohet se subjekti dha sqarime të plota dhe, si përfundim, në këtë rast nuk konstatohen problematika në lidhje me vendimmarrjen e subjektit të rivlerësimit.

**53.** Bazuar në informacionet e mara pranë organeve ligjzbatuese u kërkuan dhe u administruan dosjet e shtetasve A. Ç. dhe G. M.

**53.1.** Në lidhje me çështjen<sup>13</sup> penale që i përket shtetasit A. Ç.

Sipas akteve të fashikullit të procedimit penal nr. \*\*\*, rezulton se:

- Në datën 2.2.2020 shtetasja E. Ç. ka bërë kallëzim penal ndaj shtetasit A. Ç., me të cilin ka pasur një lidhje prej rreth 7 vitesh (duke pretenduar se e ka kapur prej xhupi, i ka marrë telefonin dhe e ka kafshuar në vesh).

- Në datën 17.2.2020, subjekti ka regjistruar procedimin penal pa autor për veprën penale “Dhunë në familje”, parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal, si dhe ka urdhëruar kryerjen e veprimeve hetimore me afat deri në datën 31.3.2020 si: të bëhet këqyrja e vendit të ngjarjes duke administruar dhe pamjet filmike; të pyeten familjaret, si dhe të administrohen certifikatat familjare; të pyeten punonjësit e policisë për identifikimin e personit nën hetim; të identifikohet saktësisht emri i personit nën hetim, duke administruar dokument identifikimi dhe gjendjen gjyqësore, etj.

- Në datën 21.4.2020 është pyetur nga OPGJ-ja shtetasi K. Sh., i biri i E. Ç., i cili ka deklaruar se në dijeninë e tij shtetasi A. Ç. nuk e ka dhunuar kurrë nënën.

- Në datën 22.5.2020, avokati i shtetasit A. Ç. ka paraqitur një memo, shoqëruar me certifikata të gjendjes civile dhe vërtetim banimi, duke i kërkuar subjektit që të ndryshohet akuza nga “Dhunë në familje” në “Plagosje e lehtë me dashje”.

- Në datën 26.5.2020, subjekti ka regjistruar emrin e personit që i atribuohet vepra penale, shtetasin A. Ç. Po në datën 26.5.2020 është njoftuar përfundimi i hetimeve, si dhe është marrë i pandehur dhe i është njoftuar akuza shtetasit A. Ç. për veprën penale të parashikuar nga neni 130.a/4 i Kodit Penal.

- Në datën 28.5.2020, subjekti ka kërkuar dërgimin e çështjes në gjyq me të pandehur shtetasin A. Ç., akuzuar për veprën penale të parashikuar nga neni 130.a/4 i Kodit Penal.

Sipas akteve të dosjes gjyqësore rezulton se:

- sipas procesverbalit të datës 3.7.2020, subjekti ka kërkuar pranimin e kërkesës për dërgimin për gjykim. Mbrojtësi ka kërkuar gjykimin e shkurtuar. Me vendim të gjykatës datë 3.7.2020 është vendosur dërgimi i çështjes me gjykim të shkurtuar për të pandehurin A. Ç.;

- mbrojtësi në pretendimet përfundimtare ka kërkuar që në bazë të nenit 63 të Kodit Penal të pezullohet ekzekutimi i dënimit me burgim dhe detyrimi për të kryer një punë në interes publik;

- sipas procesverbalit të seancës gjyqësore datë 9.12.2020, në konkluzione përfundimtare subjekti ka kërkuar deklarinimin fajtor të të pandehurit për veprën penale “Dhunë në familje” të parashikuar nga neni 130 a/4;

- me vendimin nr. \*\*\*, datë 9.12.2020, gjykata ka vendosur deklarinimin fajtor të të pandehurit për veprën penale “Dhunë në familje” të parashikuar nga neni 130 a/4 i Kodit Penal. Ky vendim nuk është ankimuar.

Sa më sipër, nga analizimi i akteve të mësipërme duket se: (i) Subjekti me regjistrimin e procedimit penal datë 17.2.2020, për veprën penale të parashikuar nga neni 130.a i Kodit Penal, nuk ka regjistruar emrin e autorit, të cilit i atribuohet vepra penale në përputhje me nenin 287 të Kodit të Procedurës Penale, veprim ky i kryer vetëm pas 3 muajsh në ditën e përfundimit të hetimeve; (ii) Nuk janë kryer veprime hetimore në kohë pasi, nga data e regjistrimit të procedimit penal

---

<sup>13</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 29.3.2024, të PPGJSHPPJ-së Elbasan dhe shkresën nr. \*\*\* prot., datë 12.3.2024, të GJSHPPJ-së Elbasan, në dosjen e Komisionit.

17.2.2020 deri në datën 21.4.2020 është bërë vetëm pyetja e shtetasit K. Sh., pra për një periudhë mbi dy muaj nuk është kryer ndonjë veprim hetimor. Sipas relacionit datë 7.5.2020 janë administruar vetëm vendim gjykate dhe certifikata të gjendjes civile. Nuk janë kryer të gjitha veprimet hetimore të përcaktuara në urdhrin datë 17.2.2020 për kryerjen e veprimeve hetimore; (iii) Nuk rezulton që prokurori të jetë shprehur me vendim sipas nenit 110/2 në lidhje me memon e paraqitur nga pala; (iv) Në datën 28.5.2020, subjekti ka kërkuar dërgimin e çështjes në gjyq për veprën penale të parashikuar nga neni 130.a/4 të Kodit Penal, ndërkohë që kjo vepër penale nuk parashikohej në Kodin Penal në kohën e kallëzimit penal datë 2.2.2020, por është parashikuar me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 35/2020, datë 16.4.2020.

Me njoftimin e rezultateve të hetimit subjektit iu kërkuar të japë sqarime në lidhje me konstatimet e mësipërme, i cili në parashtrimet<sup>14</sup> e tij sqaroi si vijon:

Në lidhje me konstatimin se me regjistrimin e procedimit penal datë 17.2.2020 nuk ka regjistruar emrin e autorit të cilit i atribuohet vepra penale në përputhje me nenit 287 të Kodit të Procedurës Penale sqaroi se:

- Pasi ka marrë në shqyrtim materialin kallëzues ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për kryerjen e veprës penale të dhunës në familje (n.130/a të Kodit Penal) duke vlerësuar se në materialin hetimor mungonin të dhëna të mjaftueshme lidhur me anën objektive, si dhe të dhënat për subjektin e figurës së veprës penale. Në këtë moment procedural ka zbatuar kërkesat ligjore të parashikuara nga neni 287 i Kodit të Procedurës Penale, i cili në njërin nga rastet parashikon regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale në momentin në të cilin ai rezulton.

- Subjekti me urdhrin e datës 17.2.2020 ka ngarkuar oficerin e policisë gjyqësore për kryerjen e veprimeve hetimore brenda datës 30.3.2020. Me relacionin përfundimtar të datës 7.5.2020, oficeri i policisë gjyqësore, pasi ka kryer disa detyra të lëna, ka bërë sugjerimin përkatës.

- Subjekti, pas studimit dhe marrjes në shqyrtim të akteve, duke vlerësuar se janë grumbulluar prova që japin të dhëna të mjaftueshme për të shënuar emrin e personit që atribuohet vepra penale, në datën 26.5.2020 ka urdhëruar zyrën e regjistrimit të bënte shënimet në regjistrin përkatës të njoftimit të veprave penale, duke vijuar me përpilimin dhe njoftimin e akteve të tjera dhe paraqitjen e kërkesës për dërgimin e çështjes për gjykim në ngarkim të të pandehurit A. Ç., i akuzuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 130.a/4 i Kodit Penal.

- Sipas subjektit, nuk qëndron konkluzioni që kemi të bëjmë me mosregjistrim emri të personit nën hetim në mënyrë të pajustificuar, pasi dukej se personi të cilit i atribuohet vepra penale, ishte i qartë që në aktet e hetimit fillestar.

- Subjekti sqaron se regjistrimi i emrit të personit në regjistrin e njoftimit të veprave nuk është çështje dëshire apo vullneti i prokurorit, por detyrim ligjor për të cituar provat ku bazohet e dhëna për identifikimin e autorit të veprës penale. Sipas tij, nuk është në diskrecionin e prokurorit që regjistron apo jo emrin e personit nën hetim dhe se neni 287 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se prokurori shënon në regjistër çdo njoftim të veprës penale dhe në të njëjtën kohë apo nga momenti që rezulton emrin e personit të cilit i atribuohet vepra penale. Sipas subjektit, regjistrimi i emrit të personit në regjistrin e njoftimit të veprave penale pa pasur të dhëna të mjaftueshme se ai është personi i dyshuar për kryerjen e veprës penale përbën mospërbushje të rregullt të detyrës për prokurorin, pasi shkel të drejtat dhe liritë themelore të personit dhe se regjistrimi i emrit të personit në regjistrin e njoftimit të veprave penale ka pasoja për personin, brenda dhe jashtë vendit.

---

<sup>14</sup> Subjekti ka paraqitur kopje të dosjes penale nr. \*\*\*, datë 9.12.2020, me të pandehur A. Ç.

Në lidhje me konstatimin se nuk janë kryer veprime hetimore në kohë pasi nga data e regjistrimit të procedimit penal, 17.2.2020 deri në datën 21.4.2020 është bërë vetëm pyetja e shtetasit Kristi Shadini, pra për një periudhë mbi dy muaj nuk është kryer ndonjë veprim hetimor, sqaroi se:

- Në rrethanat konkrete (pandemia Covid-19), oficeri i policisë gjyqësore kishte kryer disa veprime hetimore procedurale dhe me relacionin përfundimtar kishte bërë dhe sugjerimin për dërgimin e çështjes për gjykim. Subjekti ka vlerësuar se provat e grumbulluara japin të dhëna të mjaftueshme për të ngritur akuzën sipas nenit 130.a/4 të Kodit Penal dhe mbrojtur atë në gjykatë.

Në lidhje me moskthimin e përgjigjes së memos së mbrojtësit sqaroi se në memon e mbrojtësit të pandehurit, administruar në datën 22.5.2020, në thelbin e saj është kërkuar ndryshimi i cilësimit juridik të faktit. Nga aktet e ndodhura në fashikull rezulton se subjekti qëndrimin e tij ia ka komunikuar të pandehurit dhe mbrojtësit të tij në datën 27.5.2020, me aktin e njoftimit të akuzës për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 130.a/4 i Kodit Penal. Kjo akuzë me procesverbalin e pyetjes së të pandehurit datë 27.5.2020 është pranuar. Pra, sipas subjektit, përgjigja e memos është ezauruar plotësisht duke zbatuar në këtë mënyrë afatin ligjor të parashikuar nga neni 110/2 i Kodit të Procedurës Penale.

Në lidhje me konstatimin se subjekti ka kërkuar dërgimin e çështjes në gjyq për veprën penale të parashikuar nga neni 130.a/4 të Kodit Penal, ndërkohë që kjo veprë penale nuk parashikohej në Kodin Penal në kohën e kallëzimit penal datë 2.2.2020, por është parashikuar me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 35/2020, datë 16.4.2020, sqaroi se:

- Në cilësimin juridik të veprës penale të dyshuar se është kryer që në momentin e regjistrimit të veprës penale, ai ka mbajtur parasysh se ligjvënësi me anë të nenit 130/a të Kodit Penal ka marrë në mbrojtje të posaçme marrëdhëniet juridike të vendosura nga shteti e që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe sigurinë e marrëdhënieve në familje, në përputhje me rregullat e vendosura në Kodin e Familjes, nga veprimet e kundërligjshme referuar ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”, Konventën e Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”. Mbi këtë parashikim ligjor ka konkluduar se në rastin konkret plotësohen kriteret formale dhe substanciale që lidhen me ekzistencën e dhunës në familje dhe të lidhjes midis të dyshuarit dhe viktimës, marrëdhënie këto të mbrojtura posaçërisht nga ligji penal nëpërmjet përdorimit të sanksioneve penale. Në rrethanat konkrete të faktit dhe nën këtë parashikim ligjor, veprimi i kundërligjshëm i kryer nga shtetasi A. Ç. e bënte këtë shtetas subjekt të figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 130.a i Kodit Penal dhe jo 89 të tij.

- sipas subjektit, ky fakt ligjor ka gjetur mbështetje edhe nga gjykata në vendimet e dhëna ndaj të pandehurit dhe ka paraqitur vendimin e gjykatës nr. \*\*\*, datë 3.7.2020 (për dërgimin e çështjes në gjyq) dhe vendimin nr. \*\*\*, datë 9.12.2020, i cili ka marrë formë të prerë në datën 24.12.2020, me të cilin është deklaruar fajtor i pandehuri A. Ç.

Në analizë të parashtrimeve, nga ana e Komisionit sqarimet e subjektit nuk qëndrojnë. Sqarimet e dhëna janë të përgjithshme, të paqarta dhe jobindëse.

Sa i takon argumenteve për mosregjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale, subjekti, nga njëra anë shprehet se sipas materialit kallëzues mungonin të dhëna të mjaftueshme lidhur me subjektin e figurës së veprës penale, nga ana tjetër shprehet se personi të cilit i atribuohet vepra penale ishte i qartë që në aktet e hetimit fillestar.

Sa i takon moskryerjes së veprimeve hetimore në kohë, si dhe moskryerjes së veprimeve hetimore të përcaktuara në urdhrin e datës 17.2.2020, subjekti nuk jep ndonjë sqarim konkret, por i referohet vetëm situatës së pandemisë Covid-19 dhe faktit se OPGJ-ja ka kryer disa detyra.

Sa i takon sqarimeve të subjektit për moskthimin e përgjigjes së memos me arsyetimin se ai e i kishte ezauruar me njoftimin e akuzës dhe se i pandehuri e kishte pranuar atë, gjenden të pabazuara, pasi neni 110/2 i Kodit të Procedurës Penale detyrimin e organit procedues që të shprehet me vendim, nuk e lidh me njoftimin e akuzës. Gjithashtu, sa i përket faktit se i pandehuri e ka pranuar akuzën në procesverbalin e pyetjes së të pandehurit, vërehet se sipas këtij procesverbali, i pandehuri, pasi e ka pranuar akuzën, është shprehur në lidhje me faktin se ndryshimet në Kodin Penal që parashikojnë dhunën në familje kanë ndodhur pas kryerjes së veprës nga ana e tij.

Sa i takon konstatimit se subjekti ka dërguar çështjen në gjyq për veprën penale të parashikuar nga neni 130.a/4 i Kodit Penal të pandehurin A., ndërkohë që kjo vepër penale nuk parashikohej në Kodin Penal në kohën e kallëzimit penal datë 2.2.2020, por është parashikuar me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 35/2020, datë 16.4.2020, sqarimet e subjektit janë të përgjithshme dhe të pambështetura në interpretim të dispozitave ligjore. Argumenti i subjektit se duke iu referuar edhe ligjit nr. 9669, datë 18.12.2006, “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare” ka konkluduar se shtetasi A. Ç. ka kryer veprim të kundërligjshëm dhe se e bënte këtë shtetas subjekt të figurës së veprës penale të parashikuar nga neni 130.a i Kodit Penal, nuk qëndron për sa kohë që:

- *Së pari*, ligji “Për masa ndaj dhunës në familje” nuk ka karakter penal, por mbrojtja që ofron ky ligj shkon paralelisht me përgjegjësinë penale të dhunuesit, referuar nenit 130/a të Kodit Penal. Qëllimi i ligjit nr. 9669/2006, “Për masa ndaj dhunës në familje” është mbrojtja e viktimës dhe marrjes së masave emergjente ndaj viktimës, ndërsa dispozita penale ka si qëllim dënimin dhe rehabilitimin e personit fajtor për dhunën në familje;

- *Së dyti*, sipas përcaktimeve të nenit 130/a të Kodit Penal, i cili ka qenë në fuqi në datën 2.2.2020, janë përcaktuar subjektet e figurës së veprës penale si: bashkëshorti, ish-bashkëshorti, bashkëjetuesi apo ish-bashkëjetuesi, gjini e afërt ose krushqi e afërt, ndërkohë që referuar akteve të dosjes është provuar se: (i) ngjarja ka ndodhur në datën 2.2.2020; (ii) i akuzuari A. Ç. me viktimën E. Ç. kanë qenë në lidhje intime me njeri-tjetrin dhe nuk kanë qenë në asnjë nga rastet e përcaktuara në këtë nen, pra nuk ka qenë subjekt i kësaj figure vepre penale. Vetëm me ndryshimet që ka pësuar ky nen me anë të ligjit nr. 35/2020, datë 16.4.2020, pra pas ngjarjes, është përfshirë si subjekt i figurës së veprës penale dhe autori i veprës penale që është në lidhje apo ish-lidhje intime me viktimën.

Sa i takon argumenteve të subjekti se akuza është pranuar nga i pandehuri, si dhe faktit që ka gjetur mbështetje edhe nga gjykata në vendimet e dhëna, për Komisionin nuk vlerësohen si justifikuese për efekt të procesit të rivlerësimit, për sa kohë që rezultoi se kualifikimi ligjor i faktit penal, i bërë nga subjekti i rivlerësimit është haptazi i gabuar si në arsyetim, ashtu edhe në zbatim të ligjit material.

Si përfundim, në këtë rast, nga ana e Komisionit vlerësohet se subjekti i rivlerësimit ka treguar mangësi në drejtim të parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 73 dhe pikës 4 të nenit 74 të ligjit nr. 96/2016. Por, duke mbajtur në konsideratë vendimin nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, sipas të cilit “*Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore të përsëritura dhe serioze dhe që tregojnë mungesë të aftësive profesionale*”, vlerëson se ky rast i vetëm nuk mund të shërbejë si provë për një vlerësim negativ të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.

### **53.2.** Në lidhje me çështjen penale që i përket shtetasit G. M.

Nga Komisioni janë analizuar aktet e fashikujve të procedimit penal nr. \*\*\*/\*\*\*, pasqyruar në mënyrë të detajuar në rezultatet e hetimit administrativ. Në përfundim të hetimit është vërejtur se: (i) me përfundimin e hetimeve subjekti nuk i ka pyetur të akuzuarit në cilësinë e të pandehurve;



(ii) çështja është kthyer dy herë në prokurori, në një rast për plotësim hetimesh dhe në rastin e dytë për ndryshim akuze; (iii) po kështu, duket se gjatë gjykimit në themel të çështjes subjekti ka ndryshuar përsëri akuzën (kërkesa për ndryshim akuze është pa datë). Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime për konstatimet e mësipërme.

Në parashtrimet<sup>15</sup> e tij, subjekti sqaroi si vijon: *“Në lidhje me konstatimin e parë, sqaroi se ka respektuar kërkesat ligjore të parashikuara në pikat 2, 3 dhe 4 të nenit 327 të Kodit të Procedurës Penale, provuar kjo me konstatimin nga gjykata të vlefshmërisë së kërkesës për dërgimin e çështjes në gjyq dhe se vetë i pandehuri ka zgjedhur të heshtë, e drejtë kjo e garantuar nga ligji procedural penal. Për të pandehurin G. M., aktet i janë komunikuar mbrojtësit të zgjedhur prej tij dhe në kushtet e pamundësisë së pyetjes së tij është kërkuar dërgimi për gjykim i çështjes në ngarkim të tij. Sipas tij, nga aktet e ndodhura në dosje provohet se të pandehurit në fazën e seancës paraprake për dërgimin e çështjes për gjykim dhe atë të gjykimit në themel, për të realizuar mbrojtjen e tyre kanë dhënë shpjegime sa herë që e kanë çmuar të nevojshme.*

*Në lidhje me konstatimin se çështja është kthyer dy herë në prokurori, në një rast për plotësim hetimesh dhe në rastin e dytë për ndryshim akuze, sqaroi se me ndryshimet që ka pësuar legjislacioni ynë penal pas vitit 2017, ligjvënësi në titullin v, kreun IX të Kodit të Procedurës Penale parashikoi si një hallkë të domosdoshme për kontrollin e hetimeve në procesit penal gjyqtarin e seancës paraprake, ndaj dhe në zbatim të këtyre kërkesave ligjore vlerësoj se është detyrë e gjyqtarit të seancës paraprake të garantojë zbatimin e ligjit procedural penal”.*

Në lidhje me konstatimin duket se gjatë gjykimit në themel të çështjes subjekti ka ndryshuar përsëri akuzën (kërkesa për ndryshim akuze është pa datë) dhe sqaroi se:

- Duke zbatuar me korrektësi ligjin procedural dhe material penal ka bindjen e plotë se në përfundim të gjykimit të kësaj çështjeje, gjykatat me vendim të formës së prerë (Gjykata e Apelit) apo me vendimin përfundimtar (Gjykata e Lartë) do t’i deklarojnë fajtor të pandehurit G. M. dhe I. B. sipas kërtimeve në konkluzionet përfundimtare të tij.

- Subjekti është i bindur në qëndrimin tij se të pandehurit kanë kryer veprat penale për të cilat ka ngritur akuzë. Është fakt se në çështjen konkrete gjyqtarët nuk kanë pasur qëndrime të njëjta, për sa i përket kualifikimit ligjor për veprat penale të kryera nga të pandehurit dhe dënimit të tyre.

- Kërkesa për ndryshim e akuzës nga subjekti është bërë me shkrim dhe me gojë në seancë ndaj dhe data e kësaj kërkesë korrespondon me datën e seancës gjyqësore.

- Ndaj këtij vendimi ka paraqitur ankim në Gjykatën e Apelit Tiranë dhe kjo çështje është dërguar pranë Gjykatës së Apelit Tiranë.

Në analizë të parashtrimeve të subjektit, nga ana e Komisionit vlerësohet se subjekti duhej të ishte treguar me i kujdesshëm dhe të kishte pyetur të pandehurit, gjë të cilën e ka ezauruar pas kthimit të akteve nga gjykata për plotësimin e hetimeve. Po kështu, nuk mund të fajësohet subjekti për shkak të ndryshimit të cilësimit juridik të fakteve nga gjykata në vendimin nr. \*\*\*, datë 15.6.2021, pasi kjo ka të bëjë me vlerësimin ndryshe nga ana e gjykatës.

Sa i takon konstatimit të tretë, sqarimet e subjektit qëndrojnë. Siç rezulton nga aktet, ndryshimi i akuzës ka të bëjë me themelin e çështjes, qëndrim që subjekti e ka mbajtur në mënyrë konsistente dhe bazuar në pikën 4 të nenit 73 të ligjit nr. 96/2016, vlerësuesi çmon aftësitë profesionale të prokurorit, pa gjykuar mbi korrektësinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet. Sa i takon datës së kërkesës, nga verifikimi i

---

<sup>15</sup> Subjekti ka paraqitur një ankim të tij ndaj vendimit të gjykatës që ka të bëjë me lënien në fuqi të masës së sigurisë “Arrest në burg” për të pandehurin I. B.

procesverbalit të datës 20.6.2022 vërehet se subjekti ka paraqitur një kërkesë me shkrim të cilën e relaton, ndërsa sipas procesverbalit të datës 24.6.2022 rezulton se subjekti është shprehur se *mbi provat e administruara vlerësojmë se akuzat janë ato të formuluarat të ndryshuara sipas kërkesës që kam depozituar.*

Bazuar në sa me sipër, sa i takon çështjes objekt verifikimi nuk u konstatuan problematika që cenojnë aftësitë profesionale të subjektit të rivlerësimit.

**54.** Në përfundim, për subjektin Petref Asllani është vlerësuar se: (i) ka treguar aftësi të mira profesionale sipas nenit 73 të ligjit nr. 96/2016; (ii) ka treguar aftësi të mira organizative sipas nenit 74 të ligjit nr. 96/2016; (iii) ka treguar etikë dhe angazhim ndaj vlerave profesionale sipas nenit 75 të ligjit nr. 96/2016; (iv) ka treguar aftësi personale dhe angazhim profesional sipas nenit 76 të ligjit nr. 96/2016. Për rrjedhojë, sipas shkronjës “a” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, me propozim të relatores së çështjes, subjekti i rivlerësimit është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se ka arritur nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale.

## **SEANCA DËGJIMORE**

**55.** Në datën 10.5.2024, sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, u zhvillua seanca dëgjimore për procedurën e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Petref Asllani, në përfundim të së cilës ai kërkoi konfirmimin në detyrë. Trupi gjykues i Komisionit pasi përfundoi procedurën e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit Petref Asllani, në mënyrë unanime vendosi shkarkimin nga detyra të tij, shpallur në seancën e datës 14.5.2024, sipas pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.

## **QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

**56.** Gjatë procesit të rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme, trupi gjykues ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016. Në të gjitha komunikimet, subjekti ka qenë i gatshëm për t’u përgjigjur brenda afateve të caktuara, por, ka pasur raste që shpjegimet/deklarimet e tij kanë qenë joshteruese dhe jo në koherencë me deklarimet ndër vite dhe atë *Vetting*, qëndrim i cili është mbajtur në konsideratë gjatë procesit të vendimmarrjes, sipas parashikimit të nenit 48 të ligjit nr. 84/2016.

## **KONKLUZION PËRFUNDIMTAR**

**57.** Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni bazuar në të gjitha provat e administruara pas një hetimi të thelluar e gjithëpërfshires, krijoi bindjen se:

- Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Petref Asllani nuk arrin nivelin kualifikues për sa i takon kriterit të pasurisë, pasi ka kryer deklarime të pasakta dhe të pamjaftueshme, sipas nenit 61/3 të ligjit nr. 84/2016, çka përbën shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra;
- Referuar nenit DH të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Petref Asllani ka arritur nivel të besueshëm për kontrollin e figurës sipas nenit 59/b të ligjit;
- Referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit Petref Asllani ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 59/c të ligjit,

Vendimarrja për subjektin është bazuar në përfundimet e arritura për kriterin pasuror si dhe në vlerësimin tërësor të procedurave, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 4, të ligjit 84/2016.

### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, sipas parashikimit të pikës 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, bazuar në shkronjën “c” të pikës 1 të nenit 58 dhe në pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **V E N D O S I:**

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Petref Asllani, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 14.5.2024.

### **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Olsi KOMICI**  
Kryesues

**Firdes SHULI**  
Relatore

**Valbona SANXHAKTARI**  
Anëtare

*Sekretare gjyqësore*  
*Jonida Vrana*